



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL  
DREJTORI EKZEKUTIV

Nr. Prot. 818

Tiranë, 25/04/2019

Lënda: Dërgohet Raportimi i Veprimtarisë Vjetore të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2018

Drejtuar: Zonjës Belinda Balluku  
Ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë

E nderuar Zonja Ministre,

Duke ju falenderuar për mbështetjen Tuaj të vazhdueshme për Autoritetin e Aviacionit Civil, më lejoni t'ju informoj se në zbatim të Nenit 20, të Ligjit nr. 10233 datë 11.02.2010 "Për Autoritetin e Aviacionit Civil" i ndryshuar, Raportimi nga Autoriteti pika 1e tij, Autoriteti i Aviacionit Civil ka hartuar një raport mbi:

- Veprimtarinë vjetore të tij, përfshirë vendimet e marra nga Këshilli Drejtues;
- Pasqyrën financiare vjetore;
- Realizimin e planit të të ardhurave e të shpenzimeve;
- Të dhënat mbi liçencat e lëshuara, regjistrat, miratimet dhe aktet e tjera individuale administrative, të nxjerra në përputhje me këtë ligj.

Ju lutem gjeni bashkëlidhur raportet.

Me respekt,

  
Krislen Keri







**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**  
**AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL**



---

**RAPORTI I VEPRIMTARISË VJETORE**  
**2018**

**Shkurtime: (Sipas Aplikimeve)**

AAC	- Autoriteti Aviacionit Civil
DMA	- Drejtoria e Mbikëqyrjes së Aeroporteve
DSHM	- Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
SKRC	- Sektori i Kontrollit dhe Ruajtjes së Cilësisë
DMSHLA	- Drejtoria e Mbikëqyrjes së Shërbimeve të Lundrimit Ajror
DMSA	- Drejtoria e Mbikëqyrjes së Sigurisë në Aviacion
DAMO	- Drejtoria e Mbikëqyrjes së Sigurisë në Operim dhe Vlerëshmërisë Ajrore
EASA	- Agjencia Evropiane e Sigurisë në Aviacion
EC	- Komisioni Evropian
ECCAIRS	- Qendra e Koordinimit Evropian Sistemit Raportimit të Incidenteve në Aviacion
IANS	- Instituti i Shërbimeve të Navigimit Ajror
ICAO	- Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil
LSSIP	- Implementimi Rajonal i Qiellit të Përbashkët
RAT	- Risk Assessment Tools
SAAQ	- Pyetëtori Shtetëror i Aktivitetit të Aviacionit
SAFA	- Vlerësimi i Sigurisë për Avionët e Huaj
SSP	- Programi Shtetëror i Sigurisë
ECAA/ ZPEA	- Marrëveshje shumëpalëshe ndërmjet vendeve evropiane rreth një tregu të vetëm.

**Tabela e Përmbajtjes**

1. PËRMBLEDHJE .....	4
1.1 MISIONI.....	4
1.2 VIZIONI .....	4
1.3 STRATEGJIA.....	5
1.4 ORGANIGRAMA .....	6
1.5 FUNKSIONET .....	7
1.6 KËSHILLI DREJTUES .....	8
1.7 DREJTORI EKZEKUTIV .....	10
2. OBJEKTIVAT PËR PERIUDHËN 2018 .....	12
3. ARRITJET PËR PERIUDHËN .....	16
4. PROBLEMATIKAT PËR PERIUDHËN.....	17
5. PROGRESI I PUNËS PËR PERIUDHEN SIPAS FUSHAVE PËRKATËSE .....	19
6. STATISTIKAT .....	50

## **PËRMBLEDHJE**

### **1.1 MISIONI**

Misioni i Autoritetit të Aviacionit Civil është të krijojme një mjedis në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare, përmes monitorimit të vazhdueshëm, ndërveprimit me operatorët dhe nivelit të lartë të kompetencës profesionale të personelit të AAC.

Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar ka përgjegjësi të qartë për rregullimin dhe mbikqyrjen e parrezikshmërisë dhe sigurisë në të gjithë veprimtarinë e transportit ajror civil në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të ligjit Nr. 10.040 datë 22.12.2008 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar. Duke qenë anëtare në Organizatat Ndërkombëtare të Aviacionit, në përputhje me detyrimet përkatëse, ne jemi plotësisht të përkushtuar "për të garantuar rritje të sigurt dhe të rregullt të aviacionit ndërkombëtar civil në nivel global". Objektivat tona për nxitjen e sigurisë integrohen me sistemet e ICAOs/ ECAC, / EASAs dhe EUROCONTROL, të traspozuar në legjislacionin bazë të aviacionit civil në R.SH, Kodit Ajror, Ligjit për Autoritetin e AAC si dhe VKM-ve, Urdhrave, Udhëzimeve të dalë me qëllim, garantimin e një transporti ajror të sigurtë.

AAC është e orjentuar drejt përmbushjes me efektivitet dhe efikasitet të nevojave të pasagjerëve dhe shoqërisë në tërësi. AAC kërkon të promovojë zhvillimin e aviacionit civil dhe të thjeshtëzojë zhvillimin ekonomik në të gjithë vendin, nëpërmjet mbështetjes dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me të gjithë palët e përfshira.

### **1.2 VIZIONI**

Vizioni i Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar është që të ketë në mënyrë të vazhdueshme dhe të përhershme siguri dhe efikasitet në bazën e aktivitetit të tij, duke u bërë kështu plotësisht i përputhshëm me rrjetin evropian të transportit ajror.


Një aspekt i rëndësishëm i aktivitetit tonë është garantimi i burimeve të mjaftueshme financiare në mënyrë që personeli të ketë aftësitë e duhura dhe trajnimet për përmbushjen e përgjegjësisë së tyre, si në lidhje me sigurinë apo funksione të tjera. AAC-ja përpiqet të nxisë konceptet dhe parimet e menaxhimit të parrezikshmërisë dhe sigurisë, si edhe të edukojë ofruesit e operatorët e shërbimit të aviacionit me këto koncepte.

### 1.3 STRATEGJIA

Strategjia mbi të cilën do të mbështetet përmbushja e qëllimit të autoritetit dhe përpjekjet për të arritur vizionin tonë bazohet në:

- ✚ Marrjen e masave të vazhdueshme nga Menaxhimi i Lartë për të garantuar parrezikshmërinë dhe sigurinë në fushën e aviacionit civil.
- ✚ Sigurimi i mbikqyrjes së vazhdueshme të operatorëve nëpërmjet auditimeve dhe inspektimeve të njoftuara e të panjoftuara.
- ✚ Transpozimi dhe Implementimi i Standarteve Europiane dhe Ndërkombëtare, në legjislacionin kombëtar.
- ✚ Punësimin e personelit me kualifikime të larta, në pajtim me kërkesat e ICAO-s dhe BE-së/EASA
- ✚ Trajnimin sistematik të personelit të ri dhe ekzistues për të garantuar ekspertizën e mjaftueshme për çdo funksion të AAC-së;
- ✚ Krijimi i një Programi Shtetëror të Sigurisë( safety) dhe Plani Shtetëror të Sigurisë (safety).
- ✚ Vendosjen e një Sistemi Menaxhimi, themeli i të cilit do të jetë baza operative e Autoritetit. Produkti i këtij sistemi do të jetë kontributi në arritjen e përmbushjes së objektivave në autoritet;
- ✚ Bashkëpunimi me Autoritetet e tjera me qëllim harmonizimin dhe standardizimin e procedurave.
- ✚ Aderimi dhe përfaqësimi dinjitoz në organizatat Europiane dhe Ndërkombëtare.
- ✚ Rritja e të ardhurave të AAC-së, si dhe menaxhimi eficient i tyre, duke realizuar investimet në funksion të përmirimit të veprimitarisë së punës.

➔ 1.4 Struktura dhe Organika e Autoritetit të Aviacionit Civil, është miratuar me Urdhër Ministri Nr.2, datë 11/01/2019.



**Shenim:** Për vitin 2018 AAC ka vepruar me Strukturën Organizative të miratuar nga Ministri Infrastrukturës dhe Energjisë, miratuar me shkresën me nr. prot 3868/5 datë 16.02.2018.

Kjo strukturë përbej nga 5 drejtori dhe dy sektorë në varësi të Drejtorit Ekzekutiv.

Ristrukturimi i institucionit është bërë sipas një propozimi të financuar nga Komisioni European dhe Eurocontrol, i cili në thelbin e tij ka rritjen e efikasitetit të punës së institucionit, ku numri i drejtorive dhe punonjësve është reduktuar.

Me strukturën e re të AAC, u ndoq procedura e vendosjes së ligjshmërisë së emërimeve me DAP.

## **1.5 FUNKSIONET**

Aktivitetet e Autoritetit lidhen kryesisht me veprimet rregullatore dhe proceduriale për të siguruar parrezikshmërinë ajrore (safety) dhe arritur nivele të pranueshme të sigurisë për të gjithë aktoret e palët e përfshira të Aviacionit Civil të R.SH.

Aktivitetet kryesore të autoritetit përfshijnë por nuk kufizohen në:

- ✚ liçencimin dhe çertifikimin e transportuesve ajror;
- ✚ liçencimin dhe çertifikimin e avionëve, përfshirë inspektimet e nevojshme të kushteve teknike dhe operacionale të avionit;
- ✚ administrimin e regjistrit të avionëve civilë dhe të çdo regjistri tjetër të aviacionit civil;
- ✚ liçencimin dhe klasifikimin e pilotëve, të anëtarëve të ekuipazhit të fluturimit dhe personelit tjetër të aviacionit, që duhet licencuar në zbatim të Kodit Ajror, përfshirë liçencimin e instruktorëve të fluturimit për këtë personel;
- ✚ liçencimin e personelit të shërbimit të lundrimit ajror (SHLA);
- ✚ liçencimin e inspektorëve të aviacionit;
- ✚ liçencimin e kontrolluesve të shëndetësisë;
- ✚ çertifikimin dhe liçencimin e aerodromeve;

- ✚ mbledhjen e informacionit për personelin e aviacionit dhe avionët, si dhe për shpërndarjen e tyre;
- ✚ mbledhjen dhe analizimin e raporteve dhe të dokumenteve të tjera për teknologjinë e aviacionit, operimin e avionëve dhe personelin e aviacionit, deri në atë masë që kjo ndihmon, për zbatimin e funksioneve, në përputhje me Kodin Ajror
- ✚ auditimin e kushteve teknike dhe operuese, si dhe të fuqisë ekonomike të sipërmarrjeve të aviacionit dhe sistemeve trajnuese të aviacionit;
- ✚ bashkërendimin, çertifikimin dhe mbikëqyrjen e sigurisë së transportit ajror
- ✚ përzgjedhjen, çertifikimin dhe mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve të lundrimit ajror;
- ✚ organizimin dhe përdorimin e hapësirës ajrore në bashkëpunim me autoritetet ushtarake;
- ✚ funksione të tjera të parashikuara në këtë Kod dhe në aktet e tjera, të dala në zbatim të tij.

## 1.6 KËSHILLI DREJTUES

Veprimtaria e AAC-së, në zbatim të ligjit për Autoritetin e Aviacionit Civil, ndihmohet nga Këshilli Drejtues, i cili është organi vendimarrës për çështjet administrative dhe financiare të Autoritetit. KD i AAC-së përbëhet nga pesë anëtarë.

Këshilli Drejtues në zbatim të Ligjit Nr. 10233, datë 11/02/2010, i ndryshuar ka këto kompetenca:

- ✚ Miraton programet e zhvillimit të Autoritetit, në përputhje me strategjinë e aviacionit civil;
- ✚ Propozon te Ministri strukturën organizative të Autoritetit dhe strukturën e pagave që do zbatohen;
- ✚ Miraton rregulloren për organizimin e brendshëm administrativ, funksionet dhe përgjegjësitë e drejtorive, sektorëve, nëpunësve dhe punonjësve të tjerë;
- ✚ Miraton programin financiar të Autoritetit dhe ndryshimet e tij, për të cilën informon ministrin, si dhe mbikëqyr realizimin e tij;

## AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

- ✚ Propozon te ministri masën e tarifave që do të zbatohen nga Autoriteti, sipas pikës 2 të nenit 17 të këtij ligji, për shërbimet që kryen, të cilat miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit që mbulon çështjet e transportit dhe Ministrin të Financave;
- ✚ Merr vendime për çështje të tjera, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi.

***Për vitin 2018 Këshilli Drejtues i AAC-së ka marrë vendime për çështje të transferimit të kapitalit apo të lidhura me buxhetin, strukturën e AAC-së, konkretisht si më poshtë:***

1	Vendim nr. 01, datë, 08.02.2018, “Pranimi i argumenteve te AAC mbi komentet e DAP për strukturën e AAC”
2	Vendim nr. 02, datë, datë, 05.03.2018, “Miratimi i përshkrimeve, detyrave dhe kërkesave për punësim ne AAC”
3	Vendim nr. 03, datë, 05.03.2018, “Miratimi i prioriteteve te AAC për 2018”
4	Vendim nr. 04, datë, 21.03.2018, “Miratimi i punësimit te përkohshëm për plotësimin e nevojave emergjente për ushtrimin e funksioneve te institucionit”
5	Vendim nr. 05, datë, 17.04.2018, “Miratimi i nismës mbi nevojën e një godine te re te AAC-se”
6	Vendim nr. 06, datë, 24.05.2018, “Për ndryshimin e programit Ekonomiko Financiar për vitin 2018”
7	Vendim nr. 07, datë, 21.06.2018, “Miratimi i lidhjes se kontratës se ofruar nga JAA TO”
8	Vendim nr. 8 datë 21/06/2018 “ Për transferim kapital të një autoveturë në pronësi të AAC, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
9	Vendim nr. 09, datë, 21.06.2018, “Miratimi i dhënies me qira te një ambienti prej 25m2 ne katin e përdhe te godinës se AAC”
10	Vendim nr. 10, datë, 31.07.2018, “Ndryshime ne programin Ekonomiko-Financiar te vitit 2018”
11	Vendim nr. 11, datë, 31.07.2018, “Për mundësimin e trajnimit baze te mjekësisë se aviacionit te aplikantëve për ekzaminues aeromjekësor”

12	Vendim nr. 12, datë, 01.08.2018, “Zëvendësimi i përkohshëm te funksionit te sekretarit te KD”
13	Vendim nr. 13, datë, 17.09.2018, “Mbi zbatimin e rekomandimeve te lëna nga KLSH për KD”
14	Vendim nr. 14, datë, 17.09.2018, “Miratimi i ndryshimeve te Ligjit Nr. 10233”
15	Vendim nr. 15, datë, 19.10.2018, “Mbi disa ndryshime ne përshkrimet e detyrave dhe kërkesave për punësim ne AAC”
16	Vendim nr. 16, datë, 07.11.2018, “Transferim kapitali te një auto veturave ne pronësi te AAC, MIE-se”
17	Vendim nr. 17, datë, 07.11.2018, “Transferim kapitali te dy auto veturave ne pronësi te AAC, Shtabit te Përgjithshëm te Forcave te Armatosura, Komandës se Forcave Ajrore”
18	Vendim nr. 18, datë, 07.11.2018 “Transferim me zyra te AAC-se ne qendrën e Biznesit “Tirana Business Park””
19	Vendim nr. 19, datë, 28.12.2018 “Transferim kapitali te një auto veturë ne pronësi te AAC ne Avokaturën e shtetit”
20	Vendim nr. 20 datë, 28.12.2018 “Miratimi i programit ekonomik për vitin 2019”
21	Vendim nr. 21, datë, 28.12.2018, “Miratimi i ndryshimeve ne strukturën organizative te AAC”

### 1.7 DREJTORI EKZEKUTIV

Gjatë vitit 2018 Drejtori Ekzekutiv ka marrë masa për drejtimin e Autoritetit në përmbushje të kërkesave të Ligjit Nr. 10233 datë 11.02.2010 “Për AAC-në” i ndryshuar, funksioneve të përcaktuara në Kodin Ajror të R.Sh. si dhe përmbushjen e objektivave strategjike të AAC-së. Veprimet përmblihen, por nuk kufizohen, si më poshtë:

- ✚ Janë dhënë urdhra për drejtimin dhe administrimin e veprimtarisë së Autoritetit, në zbatim të disiplinës së punës dhe respektimit të etikës në punë;
- ✚ Janë paraqitur pranë Këshillit Drejtues propozime për ndryshime në strukturë, rialokim fondesh, ndryshim në programin ekonomik etj. Propozimi për ndryshim i strukturës është bërë sipas një

- propozimi të financuar nga Komisioni European dhe Eurocontrol, i cili në thelb ka rritjen e efikasitetit të punës në institucion;
- ✚ Ka ndërmarrë masa në lidhje me projektimin e ndryshimeve në Ligjin Organik të AAC-së dhe Kodin Ajror;
  - ✚ Ka ngritur grup pune për rishikimin e Rregullores së Brendshme të AAC-së, dhe krijimi e një seti të integruar dokumentash ku caktohen parimet e përgjithshme të funksionimit të institucionit, përshkrimet e punës për çdo punonjës dhe funksionet si dhe kriteret bazë të punësimit;
  - ✚ Është siguruar që objektivat e vendosura në Planet Vjetore nga drejtoritë e AAC janë përmbushur, duke monitoruar në mënyrë periodike nëpërmjet programit Microsoft Project, zbatimin e planit të punës;
  - ✚ Është angazhur dhe ka krijuar të gjitha mundësitë për mbrojtjen e të drejtave të pasagjerëve, nëpërmjet zyrës së të drejtave të pasagjerëve të alokuar pranë aeroportit, ndërgjegjësit të këtyrë të drejtave nëpërmjet prezencës në aeroport, komunikimit audioviziv, faqes zyrtare të AAC-së apo adresimin e kësaj problematike pranë takimit me përfaqësues të kompanive ajrore.
  - ✚ Ka ndërmarrë nismën për publikimin për herë të parë të një buletini mujor për punën e AAC-së, e cila shërben për të rritur transparencën e institucionit me publikun e gjerë dhe median kombëtare;
  - ✚ Ka miratuar Planin e Trajnimeve të detajuar për çdo pozicion, pas vlerësimit nga organizata europiane trajnuese mbi rritjen e kapaciteteve dhe kualifikimeve të inspektorëve, e cila synon të përafrojë kërkesat e nevojshme të stafit, si detyrim i Organizatave Ndërkombëtare të Aviacionit Civil.
  - ✚ Në funksion të trajnimit të vijueshëm të detyrueshëm të inspektorëve të AAC-së, për herë të parë është lidhur një marrëveshje me JAA, Organizatën Europiane të Trajnimeve, për ofrimin e këtyre trajnimeve in-house.
  - ✚ Është firmosur Memorandumi Shqipëri- Itali midis dy autoriteteve të aviacionit civil me synim forcimin e bashkëpunimit mes dy institucioneve.

- ✚ Është firmosur Memorandumi Shqipëri-Turqi, midis dy autoriteteve të aviacionit civil, me qëllim forcimin dhe rritjen e bashkëpunimit, në vecanti për sa i takon zhvillimeve në ndërtimin, certifikimin dhe mbikqyrjen e aeroporteve.
- ✚ Ka zhvilluar takimin me Drejtorat e Përgjithshëm Rajonal të Aviacionit Civil, në Tiranë.
- ✚ Drejtori Ekzekutiv gjatë vitit ka përfaqësuar AAC në mbledhjet me të larta të organizuara në fushën e aviacionit civil, si takimi në Bruksel për Zonën e Përbashkët Europiane të Aviacionit, ku ngriti shqetësimin dhe problematikat që hasin pasagjerët shqiptarë me disa linja ajrore të licensuara nga një vend anëtar i BE. Pjesmarrja në takimin e 36 të ECAC e cila zhvillohet një herë në tre vjet, Pjesmarrja në ICAO, Montreal ku u adresuan sfidat ekzistuese dhe të ardhshme për teknologjinë e sigurisë dhe inovacionit, pjesmarrja në Austri me Drejtorët e Përgjithshëm të Aviacionit Civil “European Aviation Summit” ku u diskutua progresi i arritur dhe masat që duhet të ndërmerren në kuadër të Strategjisë së Aviacionit për Europën.
- ✚ Ka ndërmarra masa për monitorimin e gjetjeve të brëndshme dhe të jashtme të institucionit.
- ✚ Janë ngritur grupe pune për mbikqyrjen dhe inspektimin e operatoreve;
- ✚ Në vijim të gjetjeve të rezultuara nga operatorët ka sjellë disa herë në vëmendje zbatimin e ligjit dhe vërejtjet ndaj tyre, ku ato ku nuk kanë rezultuar efikase është marrë masa e gjobës sipas parashikimeve në Kodin Ajror.
- ✚ Ka lëshuar autorizime, miratime të liçencave sipas kategorive përkatëse si dhe certifikatave në funksion të përmbushjes së detyrimeve në Kodin Ajror.
- ✚ Janë nxjerrë urdhra të brëndshëm për prokurimin e objekteve të parashikuara në regjistrin e parashikimeve për vitin 2018;
- ✚ Jane marrë vendime mbi miratimin e procedurave, manualeve të brëndshme të autoritetit me qëllim permirësimin e punës në AAC.

## **2. OBJEKTIVAT PËR PERIUDHËN 2018**

Objektivat të AAC për vitin 2018, në funksion të detyrimeve që rrjedhin nga Kodi Ajror dhe rregulloret kombetare, kryesisht konsistojnë si më poshtë:

- ✚ Detyra liçencuese/çertifikuese dhe aprovime/miratime të operatorëve të Aviacionit Civil
  - Çertifikimi/ Liçencimi i operatorëve
  - Çertifikimi/Liçencimi i stafit të operatorëve
  
- ✚ Detyra mbikëqyrëse të Operatorëve të Aviacionit Civil, realizimi i plotë i planit të mbikëqyrjes.
  - Faza përgatitore për kryerjen e inspektimeve/auditimeve
  - Ndjekja e planeve të inspektimit pranë operatorëve
  - Ndjekja e gjetjeve të rezultuara nga inspektime/auditime të operatorëve
  
- ✚ Detyra rregullatore në funksion të standartizimit të rregullore në fushën e transportit ajror të cilat rrjedhin në zbatim të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe marrëveshjes “Për krijimin e një zone të përbashkët në fushën e aviacionit civil”. Transpozim i rregulloreve europiane të përfshira në Aneksin 1 të Marrëveshjes Shumëpalëshe. Hartimi, monitorimi dhe përshtatja e rregulloreve, procedurave të brëndshme dhe të jashtme në përputhje me standardet e ICAO-s dhe rregulloreve të BE.
  
- ✚ Në Planin Strategjik të AAC-së hartuar nga Drejtori Ekzekutiv dhe miratuar nga Këshilli Drejtues objektivat kryesore të autoritetit kanë konsistuar në:

- **Miratimi i dokumenteve me rëndësi strategjike**

Gjatë vitit 2018, AAC ka përgatitur Strategjinë e Aviacionit Civil (SAC), e cila përcakton drejtimet dhe masat kryesore për zhvillimin e sektorit të aviacionit civil në Shqipëri për një periudhë dhjetë vjeçare, e cila është në fazë shqyrtimi pasi lidhet me miratimin e zhvillimit të Masterplanit të Aviacionit Civil.

- **Hartimi i një plani për të garantuar përputhshmërinë e plotë të legjislacionit, akteve rregullatore dhe procedurave me ato të Bashkimit Europian.**

Hapja e pritshme e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, do të paraqesë një sfidë të rëndësishme në drejtim të përafrimit të të gjithë korpusit ligjor dhe rregullator të vendit me standardet europiane.

Në përballje të kësaj sfide, AAC ka hartuar një plan të plotë masash në interes të rishikimit, plotësimit dhe përafrimit të të gjithë bazës ligjore, rregullatore dhe proceduriale me atë të BE.

- **Studimi i nevojave për ndryshime dhe hartimi i draftit të ndryshimeve eventuale në Kodin Ajror të RSH**

Dinamika e shtuar në fushën e transportit ajror, nevoja për përshtatje të mëtejshme të legjislacionit të vendit me atë të Bashkimit Europian si dhe ndryshimet e shumta në aspektin teknologjik dhe atë menaxherial e bëjnë të nevojshëm studimin rreth nevojave për ndryshime të mundshme në Kodin Ajror të RSH, me qëllim që sektori i aviacionit civil të krijojë të gjitha hapësirat dhe standardet e duhura për të përballuar sfidat dhe

mundësitë e reja. Projektligji është rikthyer në Nëntor pasi nuk janë reflektuar ndryshimet e miratimit të Rregullores së Re Bazë mbi Rregullat e Përbashkëta në fushën e Aviacionit Civil.

- **Vlerësimi i mundësisë për ndryshime ligjore për përshtatjen e statusit të punonjësve të AAC.**

Me qëllim që të shmangen problemet e krijuara nga përcaktimet të ndryshme ligjore rreth statusit të punonjësve të AAC, u ndërmorën hapa për të propozuar ndryshimet e nevojshme në legjislacioni që rregullon statusin e tyre, në përputhje me nevojat e zhvillimit dhe me praktikat më të mira europiane.

- **Hartimi i bazës së nevojshme ligjore lidhur me mjetet ajrore e pilotuara në distancë**

Zhvillimet e vrullshme në fushën e aviacionit civil dhe posaçërisht futja e gjerë në përdorim e mjeteve të papilotuara ajrore shtrojnë nevojën që edhe vendi ynë të krijojë bazën e nevojshme ligjore për të shfrytëzuar mundësitë, por edhe për të përballuar sfidat, që lindin gjatë këtij procesi. – projekti i kësaj rregulloreje ndodhet pranë MIE-s për miratim.

- **Hartimi dhe miratimi i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë**

Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë së AAC, do të synojë të krijojë kushtet që institucioni të kryejë më mirë funksionet në kushtet e një faze të re të zhvillimit të sektorit të aviacionit civil në vend.

Qëllimi i themelimit dhe zbatimit të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë (SMC) është përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve tona nëpërmjet monitorimit, matjes dhe raportimit në lidhje me performancën dhe menaxhimin e sistemeve të garantimit të sigurisë dhe proceseve të tyre. Mbikqyrja dhe monitorimi i vazhdueshëm i parrezikshmërisë dhe sigurisë si dhe efienca maksimale është thelbi i aktiviteteve të Autoritetit.

Pjesë e SMC është edhe miratimi i Procedurave Standarde Operacionale (PSO) të AAC.

Faza e re në të cilën po futet zhvillimi i aviacionit civil në vend dhe posaçërisht shtimi me ritëm të lartë i flukseve turistike si dhe i trafikut ajror kërkojnë një paketë të re dhe të përmirësuar të Procedurave Standarde Operacionale të AAC.

SMC ka filluar implementimin brënda AAC-së dhe synojmë që brënda muajit Dhjetor 2019 të certifikohemi me ISO 9001:2015.

- **Miratimi i kriterëve të punësimit dhe të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve të AAC**

Profesionalizimi dhe standardet e larta etike paraqesin kriterë të domosdoshme për të gjithë punonjësit e AAC. Vendosja e tyre dhe garantimi i vijueshmërisë së mbajtjes së tyre do të sigurohet nëpërmjet një pakete të plotë dhe të gjerë kriteresh profesionale dhe etike, të cilat do të hartohen në kuadër të një procesi serioz që AAC do të zhvillojë në bashkëpunim me institucionet e tjera, universitetet dhe partnerët ndërkombëtarë.

Një aspekt i ri dhe i rëndësishëm i kriterëve është lidhja e certifikimit progresiv në rritje të punonjësve me pozicionin në strukturë dhe me pagën. Kriteret e punësimit janë miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues.

- **Hartimi i një plani të integruar studimesh në fushën e AAC**

Zhvillimit të aviacionit civil në vend duhet t'i paraprijë një program i gjerë studimesh, të cilat do të synojnë të identifikojnë potencialet e pashfrytëzuara, të përcaktojnë objektiva të rinj si dhe të rekomandojnë mënyra dhe rrugë të përshtatshme për të mundësuar shndërrimin e hapësirës ajrore të vendit në një përmasë të re zhvillimi për ekonominë, turizmi, kulturën, ruajtjen e mjedisit dhe garantimin e sigurisë kombëtare.

Studimet e vlefshme në këtë fushë do të mundësohen falë përpjekjeve të bashkërenduara të AAC me institucionet e tjera të vendit dhe të huaja, ku roli i universiteteve dhe i sipërmarrjeve private është me rëndësi të veçantë.

Është kryer studimi mbi impaktin e cmimit të karburantit, në vijim të planit CORSIA. Është kryer studimi i impaktit ekonomik të TIA-s.

- **Hartimi i raporteve kryesore për veprimtarinë e AAC, i paraqitet në zbatim të ligjit brënda afateve kohore Këshillit Drejtues dhe Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë.**

Gjithashtu përveç sa më lart cdo drejtori brënda AAC-së harton Plane Vjetore me objektiva të matshme dhe persona përgjegjës.

AAC angazhohet gjithashtu në:

- ✚ Koordinimin dhe përfaqësimin në Organizatat Ndërkombëtare të ICAO, EASA, EUROCONTROL, ECAC, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet e RSH me këto organizata;
- ✚ Zbatimin e Planeve Korrigjuese të rezultuara nga detyrat e lëna nga vizitat e organizmave të jashtëm auditues.
- ✚ Koordinimi me strukturat si Policia e Shtetit, Dogana Shqiptare, Forcat Ajrore, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Jashtme me qëllim rritjen e masave dhe garantimin e sigurisë në aviacion.
- ✚ Koordinim, bashkëpunimin dhe zhvillimin e takimeve dypalëshe me Autoritetet e vëndeve fqinje.
- ✚ Menaxhimi i burimeve njerëzore të AAC në funksion të kryerjes së detyrave përkatëse me qëllim përmbushjen e standardeve për ruajtjen dhe rritjen e cilësisë në Aviacionin Civil;
- ✚ Raportime të brëndshme dhe planifikime;
- ✚ Zbatimin e strategjisë dhe politikave ekonomike-financiare të Autoritetit, të përcaktuara nga strukturat drejtuese, Këshilli Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv;
- ✚ Pajisjen me kredenciale për inspektorët e AAC-së;

## AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

- ✚ Evidentimi i vonesave dhe anulimeve të fluturimeve të shoqërive ajrore që operojnë në Republikën e Shqipërisë, hartimi i raporteve mujore dhe monitorimi i zbatimit të të drejtave të pasagjerëve për çdo rast.
- ✚ Mbështetjen e drejtorive operacionale dhe teknike në përmbushjen e detyrave funksionale;
- ✚ Garantimi i shpërndarjes së fondeve sipas nevojave të drejtorive;
- ✚ Garantimi i kushteve për ushtrimin normal të veprimtarisë së Autoritetit;
- ✚ Përfaqësimi ligjor i AAC-së në të gjitha nivelet e gjykit;
- ✚ Realizimi i procesit të prokurimit, me qëllim realizimin në kohë dhe në mënyrë eficiente të planit financiar.

Për sa me sipër, përdoruesit e shërbimeve të Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar për periudhën janë:

Klientet	NIPT	Shërbimi
1   Aeroporti Ndërkombëtar "Nënë Tereza" (TIA)	K51612012D	CERTIFIKIM / MBIKQYRJE
2   ALBCONTROL sh.a	J61908011H	CERTIFIKIM / MBIKQYRJE
3   Kompania Ajrore ALBAWINGS	L51418010M	CERTIFIKIM / MBIKQYRJE
4   MJEKU AEROMJEKSOR		CERTIFIKIM / MJEKU
5   SHEGA AIR	L41803004T	LEJE FLUTURIMI
6   HELIKOPTERS ALBANIA	L11808017D	CERTIFIKIM / MBIKQYRJE
7   FEDERATA AEREONAUTIKE SHQIPTARE	K41919005R	LICENSIM PILOTESH PARAGLAJDER

### 3. ARRITJET PËR PERIUDHËN

Gjatë vitit 2018 arritjet kryesore kanë konsistuar në:

- ✚ Për herë të parë është bërë kryerja e ristrukturimit të institucionit sipas një propozimi të financuar nga Komisioni Europian dhe Eurocontrol, i cili në thelbin e tij ka rritjen e efikasitetit të punës së institucionit, ku numri i drejtorive dhe punonjësve është reduktuar;
- ✚ Për herë të parë në fokus ka qenë mbrojtja e të drejtave të pasagjerëve dhe kompensimi rekord i tyre me 500 çështje të mbyllura dhe 1136 çështje të hapura të cilat janë pranuar dhe priten të

kompensohen, nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe rolit ndihmës të Autoritetit të Aviacionit Civil dhe në vecanti, stafit të AAC-së së të drejtave të pasagjerëve të alokuar pranë aeroportit;

- ✚ Publikimi për herë të parë i një buletini mujor Posta Ajrore, për punën e AAC-së, e cila shërben për të rritur transparencën e institucionit me publikun e gjerë dhe median kombëtare; publikimi cdo muaj i performancës së operatorëve ajror;
- ✚ Miratimi për herë të parë i një Plani individual Trajnimesh për stafin e autoritetit të detajuar për cdo pozicion, në bashkëpunim me organizatat europiane trajnuese, mbi përmbushjen e standarteve europiane të kualifikimeve të inspektorëve teknik;
- ✚ Për herë të parë është lidhur një marrveshje me JAA, Organizatën Europiane të Trajnimeve, për ofrimin e trajnimeve in-house, ku nga kjo mundësi kanë përfituar në pjesëmarrje shumë inspektorë. Vetëm në vitin 2018 janë mundësuar 4 trajnime in house nga JAA lidhur me Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë, Human Factor, Dangerous Goods 6, International Aviation LAW;
- ✚ Gjatë vitit 2018 janë mundësuar nga ICAO ofrimi i dy trajnimeve të rëndësishme in house, AVSEC Inspector dhe CAA Senior and Middle Managers Training Course; Për herë të parë u arrit që stafi i Drejtorisë së Mbikqyrjes së Sigurisë në Aviacion të certifikohet si Inspektor i Sigurisë në Aviacion sipas standarteve të ICAO-s.
- ✚ Firmosja e Memorandumit Shqipëri- Itali midis dy autoriteteve të aviacionit civil me synim forcimin e bashkëpunimit mes dy institucioneve;
- ✚ Firmosja e Memorandumit Shqipëri-Turqi, midis dy autoriteteve të aviacionit civil, me qëllim forcimin dhe rritjen e bashkëpunimit, në vecanti për sa i takon zhvillimeve në ndërtimin, certifikimin dhe mbikqyrjen e aeroporteve;
- ✚ Për herë të parë u morën masa administrative, gjobë në vlerë monetare 500.000 (pesëqind mijë lekë) ndaj operatorit TIA, për shkelje të rregullave të sigurisë.
- ✚ Fillimi i procesit të certifikimit të Kompanisë Ajrore Air Albania, e cila u materializua me regjistrimin në Regjistrin Shqiptar në 2019 në vijim të një pune voluminoze, serioze dhe të përkushtuar të inspektorëve të AAC-së.
- ✚ Angazhimi në grupin negociator të Aeroportit të Kukësit

- ✚ Angazhimi në grupin negociator për Aeroportin e Vlorës
- ✚ Mbyllja e gjetjeve të EASA-s mbi SAFA audit.
- ✚ Hartimi i materialeve udhëzuese për operatorin nga cdo drejtori teknike.

#### **4.PROBLEMATIKAT PËR PERIUDHËN**

- ✚ Në vijim të shkeljeve të evidentuara nga Komisioneri i Shërbimit Civil mbi emërimet e paligjshme të punonjësve gjatë viteve 2014-2017 AAC, Drejtori Ekzekutiv zbatoi detyrimet ligjore, që i ngarkon ligji nr. 152/2013 “ Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, duke shpalluar pavlevshmërinë e akteve administrative. Për sa më lart gjatë vitit 2018 institucioni ka pasur vende vakante të paplotësuara në ndjekje të shpalljes së këtyre pozicioneve dhe zhvillimit të konkursit pranë DAP.
- ✚ Shumë pozicione pune në AAC, qoftë dhe të nivelit "specialist", sipas standarteve të Bashkimit Evropian, ndër të tjera kërkojnë pasjen e eksperiencës në industrinë e aviacionit. Në kushtet kur sistemi aktual e në fuqi, i punësimit apo lëvizjes në karrierë vë barriera burokratike, të pa lidhura me performancën apo eksperiencat, kualifikimet dhe aftësitë në punë, plotësimi i këtij kriteri ka qënë i pamundur deri më sot. Për rrjedhojë, jo vetëm nuk ka qënë i mundur punësimi i specialistëve të fushës, por ka rezultuar i vështirë motivimi dhe mbajtja në punë e specialistëve ekzistues. Ky problem shoqërohet me kosto financiare dhe me kosto në burime njerëzore, duke detyruar institucionin që shpesh herë të lidhë kontrata shërbimi për kontraktimin e ekspertëve të huaj të fushës, për mbulimin e funksioneve të caktuara.
- ✚ Gjithashtu gjatë kryerjes së funksioneve mbikqyrëse ka pasur vështirësi në realizimin e detyrave, për shkak të pengesave të lidhura me pamundësinë e shpërblimit të punës jashtë orarit, si edhe të lidhura me kapacitetin e pamjaftueshëm rast pas rasti. Psh sektori i Pasagjerëve duhet të gjendet pranë pasagjerit në cdo orar të mundshëm, po ashtu inspektorët SAFA mund të duhet të punojnë jashtë orarit zyrtar gjithashtu. Pra, sistemi i shërbimit civil, ndonëse një sistem i rekomanduar për administratën publike, nuk ka rezultuar efektiv për administratën e Autoritetit të Aviacionit Civil, ndoshta edhe për specifikën që mbart ky institucion.
- ✚ Adoptimi i shpeshtë i legjislacionit vendas me atë të EU, si dhe fakti që Shqipëria nuk është EU Member, e vështirëson aplikimin dhe harmonizimin në aspektin kohor të rregullave dhe kërkesave të EU;

- ✚ Mos miratimi i rregulloreve të dërguara në MIE gjatë vitit 2018.
- ✚ Mos miratimi i Kodit Ajror të përmirësuar i cili është edhe gjetje e EASAs

## 5. PROGRESI I PUNËS PËR PERIUDHEN SIPAS FUSHAVE PËRKATËSE

*Më poshtë është paraqitur një tablo e përmbledhur e veprimtarisë kryesore vjetore sipas fushave për vitin 2018.*

### 5.1 Çështje të Parrezikshmërisë (safety) në fluturim për operatorët ajror

Në kryerjen e detyrave të saj funksionale dhe institucionale, AAC-ja promovon zhvillimin e Aviacionit Civil duke garantuar sigurinë në fluturim, përputhjen me standardet dhe praktikën e rekomanduara të ICAO-s po ashtu dhe Rregulloret dhe Direktivat e BE-së si dhe kërkesave të tjera të lidhura me çështjet e Operimeve, Vlefshmërisë Ajrore dhe Mirëmbajtjes, si dhe të Ekuipazhit Ajror dhe Organizatave përkatëse.

*Ndër aktivitetet kryesore të kësaj drejtorie përgjatë vitit 2018 mund të përmendim:*

#### 5.1.1 Përmbledhje të aktivitetit në fushën e vlefshmërisë ajrore.

Gjatë këtij viti dinamika e punës ka konsistuar kryesisht:

- 3 Miratime të “Programit të mirëmbajtjes” (ZA-AWB/ZA-ALB/ZA-KEI)
- 1 Lëshim “Çertifikata e Regjistrimit “ (ZA-AWB)
- 2 Lëshime “Çertifikata e Zhurmave “ ( ZA-AWB/ZA-ALB)
- 2 Lëshime “Çertifikata e vlefshmërisë ajrore” (CofA) (ZA-AWB/ZA-ALB)
- 2 Lëshim ARC (ZA-AWB/ZA-ALB)
- 4 Pranime të organizatave të mirëmbajtjes (“Aerostar” Rumani, “Atitech” Itali, “FL Technic” Lituani, Turkish Technics Turqi..
- 2 Modifikime të “Çertifikatës së Miratimit të Organizatës së Menaxhimit të Vlefshmërisë Ajrore”, (CAME)
- 2 Miratime të Listës Minimale të pajisjeve (MEL)
- 3 Miratime të “Manualit të Menaxhimit të Vlefshmërisë Ajrore”, (CAME)
- 4 Lëshime të licensave të teknikëve Part-66 të operatorit Albawings
  - o Agron Shkodra, Arben Ukperaj, Andi Klefti, Altin Braushi
- 5 Inspektime fizike të avioniëve ZA-AWA/ZA-ALB/Helikopter
- 1 Inspektim ACAM ZA-AWA.
- 1 Inspektim i organizatës së mirëmbajtjes Fly Technics
- 5 Audite/Inspektime në CAMO
  
- Në muajin Janar 2018 u kryen të gjitha procedurat sipas kuadrit rregullator për regjistrimin dhe certifikimin e avionit të dytë me regjistrim ZA-AWB të kompanisë ajrore “Albawings” sh.p.k.
- Miratimi i dokumentacionit të nevojshëm për kompaninë Shega Air, në kuadrin e aplikimit të saj për marrjen e AOC.

- Në kuadrin e marrjes së AOC dhe miratimit të CAMO-s për kompaninë “Viva Helicopters” Aquila & Victory invest sh.p.k. është bërë ndjekja hap pas hapi e procedurave për miratimin e CAMO-s. Pritet plotësimi i dokumentacionit të kërkuar nga ana e Autoritetit Aviacionit Civil.
- Në datën 06/04/2018 u realizua audit i CAMO-n e “Albawings”. Nga i gjithë audit i kryer u vu re se çdo punë kryej me përgjegjësi të plotë, duke zbatuar legjislacionin në fuqi.
- Në datën 28/05/2018 u realizua inspektimi ACAM i avionit me shenjë regjistrimi ZA-AWA.
- Në muajin Korrik 2018 u krye inspektimi fizik i avionit të dytë me regjistrim ZA-AWB të kompanisë ajrore “Albawings” sh.p.k.
- Mbështetur në kërkesën e kompanisë Air Albania për marrjen e AOC me bazë avionin A319-132 me regjistrim ZA-BEL, u kontrolluan dokumentet e mëposhtme:
- Manuali i Menaxhimit të Vazhdueshmërisë së Vlefshmërisë Ajrore (CAME), i cili është gati për tu miratuar.
- Shqyrtimi i Programit të Mirëmbajtjes së avionit A319-132 i cili është gati për tu miratuar.
- Shqyrtimi i Programit të Besueshmërisë së avionit A319-132 i cili është gati për tu miratuar.
- Në muajin Gusht filloi procedura për pranimin e organizatës së mirëmbajtjes Turkish Technics e cila do të kryejë mirëmbajtjen e avionit të kompanisë ajrore Air Albania. U krye inspektimi i kësaj organizate duke përfshirë edhe kapacitetet dhe facilitetet e saj.
- Në kuadrin e marrjes së AOC dhe miratimit të CAMO-s për kompaninë “Air Albania” sh.p.k. është bërë ndjekja hap pas hapi e procedurave për miratimin e CAMO-s. Eshte kryer intervista dhe është pranuar Camo Post Holder i Air Albania. Është kërkuar nga ana e inspektorëve të Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar kryerja sa më parë e një trajnimit A320 Family Familiarisation si kusht për pranimin e këtij Post Polderi.
- Në muajin Tetor u lëshuan licensat e teknikëve Part-66 të operatorit Albawings.
- Në datë 08-10 të muajit Nëntor 2018 u krye inspektimi fizik i parë i avionit të tretë me regjistrim ZA-ALB të kompanisë ajrore “Albawings” sh.p.k.
- Në kuadrin e marrjes së AOC dhe miratimit të CAMO-s për kompaninë “Air Albania” sh.p.k. është bërë ndjekja hap pas hapi e procedurave për miratimin e CAMO-s. Eshte kryer intervista dhe është pranuar Camo Post Holder i Air Albania. U kërkuar nga ana e inspektorëve të Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar kryerja sa më parë e një trajnimit A320 Family Familiarisation si kusht për pranimin e këtij Post Holderi. Trajnimi u krye nga ana e AIR ALBANIA pranë organizatës së trajnimeve Turkish Technic të miratuar nga EASA.
- Në bazë të planit vjetor për inspektimin dhe mbikëqyrjen e Organizatave që kryejnë veprimtarinë e tyre në vendin tonë kemi kryer inspektime dhe audite të cilat i kemi ndarë në disa pika të fushës së mbulimit në tre mujore, por që janë pjesë e ciklit 24-mujor të auditeve për mbikëqyrjen e vazhdueshme të organizatave, bazuar në planin vjetor 2018 të DAMO-s.

#### **5.1.2 Mbikqyrja e Sigurisë në operim;**

- Jane kryer 70 SAFA inspection ( 1 SANA).
- Eshte kryer audit i EASA per SAFA/Ramp inspection 19-22.02.2018 dhe gjetjet e ketij audit jane ne mbyllje sipas afateve te percaktuara nga EASA.
- Jane kryer gjithsej 30 En Route inspection eith Albawings (Cockpit dhe Kabine).
- Jane kontrolluar dhe analizuar Manualet e Air Albania 2 here (nje here elektronike dhe nje here manualet e derguara direkt nga aplikuesi Air Albania per vazhdimin e procedurave per AOC sipas afateve ).
- Inspektim per FSTD (Pilotet e Albawings) ne Hollande 31.03.2018

- Me urdher te Drejtorit Ekzekutiv u krijua grupi i punes per regjistrimin e avionit te Albawings dhe ndryshimi i AOC (Janar 2018).
- Ne kuadrin e mbylljes se gjetjeve te EASA RAMP Inspection (gjate vizites standartizuese 19-22 Shkurt 2018) u perpilua dhe u nxoren detyrat per zbatimin e Urdherit te Drejtorit Ekzekutiv (Nr.166, date 2.05.2018) "Per kryerjen e Inspektimeve ne VQA ne çdo kohe nga Drejtoria DAMO"
- Shqyrtimi i kerkeses per rregjistrimin, certifikimin dhe ndryshimin e Certifikates se Operatorit Ajror , ( Shtimi i avionit te ri ne floten e kompanise) per Operatorin Albawings.

*Gjatë vitit janë kryer 36 inspektime pranë Albawings.*

*Gjetje të rezultuara gjatë vitit 2018 pranë operatorit Albawings janë 7, të cilat janë të nivelit mospërputhshëmri e vogël.*

*Gjetje të rezultuara nga inspektimet enroute pranë operatorit Albawings janë 12, të cilat janë të nivelit mospërputhshëmri e vogël.*

### **5.1.3. Licensimi i personelit ajror;**

1. Është lëshuar Certifikata e Autorizimit të mjekut Aeromjekësor Dr. Shahu, datë 27/03/2018
2. Është bërë lëshimi i Licensës së Pilotit Privat A. Lama PPL (H) AL.FCL 008, më datë 18.07.2018
3. Është bërë Pezullimi dhe kthimi në Autoritetin e Aviacionit Civil i licensës së pilotit Privat A. L. PPL (H) AL.FCL 008
4. Gjatë muajit shtator -tetor është bërë Lëshimi i 30 dëshmime të Ekuipazhit të Kabinës të shoqërinë Air Albania.
5. Në përputhje me planin e mbikëqyrjes të aprovuar ne planin e punëve të vitit 2018, gjatë kësaj periudhe janë kryer 55 Inspektime Ramp dhe 10 Inspektime En Route në kompaninë Albawings .
6. Në zbatim të planit të mbikëqyrjes në Tetor 2018 është bërë audit në Dosjet e Ekuipazhit Fluturues pranë Kompanisë Albawings.
7. Në Kompaninë Albawings në muajin Maj është inspektur trajnimi i njoftuar "Operator Conversion Course" për Flight Crew dhe Cabin Crew.
8. Në muajin Qershor është kryer Audit i aktivitetit dhe faciliteteve të ekzaminuesit Aeromjekësor (AME Nr.001) Dr. K. Shahu.
9. Është përgatitur Manuali Udhëzues për Licensimin e Pilotëve të Paraglajdëve dhe Deltaplaneve, miratuar me Vendim Nr. 2209 datë 19.12.2018
10. Është përcjellë për aprovim në MIE draft rregullorja "Për miratimin e rregullores për sistemet e mjeteve ajrore të pilotuara në largësi" përfshirë këtu dhe Format e ndryshme sipas fushave përkatëse, Tetor 2018.

### **5.1.4. Cështje të regjistrimit të avionit dhe Standartizimit Teknik, aktiviteti kryesor ka konsistuar si më poshtë:**

- Është përcjellë në MIE për miratim, një grup me rregullore të projektuara në AAC. Këto projekte, janë paraqitur edhe më parë në Ministrinë e Transportit dhe këtë herë u ripanë e u ridërguan përsëri.
- Projekt Kodi Ajror i përcjellë nga MIE për mendim, u rishikua dhe u bënë rekomandimet përkatëse, të cilat u dërguan përsëri në MIE.

- Në zbatim të Planit vjetor të DAMO, u dërguan për përkthim rregulloret europiane lidhur me sigurinë në operime, si dhe disa akte të tjera ndërkombëtare si konventa apo protokolle për amendimin e këtyre konventave.
- Projekt Kodi Ajror është diskutuar në Komisionet.
- Në MIE është dërguar informacioni dhe tabelat e përputhshmërisë në lidhje me rregulloret e BE-së, si dhe Draft-Rregulloret përkatëse.
- Drejtorive në AAC u është sjellë në vëmendje përgatitja e tabelave të përputhshmërisë për rregulloret që janë aktualisht të transpozuar, në mënyrë që të përdoren gjatë vizitës vlerësuese të ECAA.
- Komunikimin zyrtar me MIE, në lidhje me negociimin e një Marrëveshjeje për Shërbimet Ajrore me Anglinë, në kuadër të BREXIT;
- Përgatitjen e informacionit për fushat e mundshme të bashkëpunimit me institucionet homologe;
- Përditësimin e informacionit për Raportin e Monitorimit të Strategjisë për Sektorin e Transportit;
- Projektimin e MoU me ENAC;
- Projektimin e projekt-udhëzimit për funksionimin e NJZP-së;-
- Përgatitjen e informacionit për licencat që trajtohen nga QKB dhe përcjelljen e procedurës për licencimin e operatorit ajror, në kuadër të procesit të deregullimit;
- Përditësimin e tabelës së akteve në kuadër të Programit Kombëtar të Integritimit.
- Projektimin e rregullave për operimin e mjeteve ajrore të pilotuara në largësi.
- Standartizimin e ndryshimit të EU Reg.748/2014.
- Standartizimin e ndryshimit të EU Reg. 965/2012.
- Përgatitjen e rregullores së droneve së bashku me relacionin përkatës.
- Përgatitjen e rregullores për deltaplanet/paraglajderat.
- Standartizimin e Rregullores së Avionëve të Aneksit II.
- Finalizimin e procesit të regjistrimit të një avioni të ri të shoqërisë Albanings shpk.

AVIONET KOMERCIAL PËR TRANSPORT PUBLIK

Nr.	Data e regjistrimit	Emri i firmës prodhuese	Data e prodhimit	Tipi	Numri Serial	Kompania pronare /Operatori	Shënja e regjistrimit	Data e regjistrimit nga RACSH	Numri i Çertifikatës	Shënime
1	23/3.2016	BOEING	1990	B 737-500	24972	AEROTRON Ireland Ltd/ Albawings	ZA-AWA		573	Terheqesi i çertifikates. G. Tole
2	04.10.2017	AIRBUS	1994	A 320-212	0427	AIRWAYS	ZA-ABB	28.12.2017	28	Çregjistruar me kerkese te pronarit
3	26.01.2018	BOEING	1989	B 737-400	24352	Me qira Albawings	ZA-AWB		574	Terheqesi i çertifikates. G. Tole
4	11.12.2018	BOEING	1990	B 737-500	24972	Albawings	ZA-AWA		573	Ndryshim pronesie Terheqesi i çertifikates. E. Turja
5	11.12.2018	BOEING	1993	B 737-400	27171	AEROTRON Ireland Ltd/ Albawings	ZA-ALB		288	Terheqesi i çertifikates. E. Turja
6	19.03. 2019	AIRBUS	2007	A 319 312	3142	WILMINGTON TRUST SP/ Airbania	ZA-BEL		792	Terheqesi i çertifikates. S. Dilek

**AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL**

**AVIONE PRIVATË DHE KOMERCIAL JO PER TRANSPORT PUBLIK**

<b>No.</b>	<b>Data e regjistrimit</b>	<b>Emri i firmes prodhuese</b>	<b>Data e prodhimit</b>	<b>Tipi</b>	<b>Numri serial</b>	<b>Kompania pronare</b>	<b>Shenja e regjistrimit</b>	<b>Data e cregjistrimit nga RACSH</b>	<b>Numri i certifikates</b>
<b>1</b>	27.05.2015	Augusta Westian	1982	A109-AII	7258	Shega Air	ZA-KEI		6873
<b>2</b>	21/10/15	Cessna 550	1979	Citation	550-0060	SHega Air	ZA-AMA		313
<b>3</b>	07/12/15	Sociata TB-10	1989	AEROSP	935	Agim Mucaj	ZA-AGM		16
<b>4</b>	22/06/16	ZENAIR	2011	STOL CH-701	7-8503	Endri Cunaj	ZA-EDE		2787
<b>5</b>	21/01/16	WSK "PZL MIELEK" Poland An-2	1974	An-2	1G156-29	Shega Air	ZA-DEA		2133
<b>6</b>	18/07/16	ZENAIR	2011	STOL CH-701	7-8504	A.E.E Sh.p.k	ZA-EXN		3316

- **5.2 Çështjet Ligjore të Aviacionit dhe Harmonizimi i Legjislacionit**

*Gjatë vitit 2018 janë projektuar një sërë aktesh rregullatore, me miratimin e të cilave realizohet harmonizimi i kuadrit ligjor vendas me atë europian.*

- AAC ka pasur si objektiv, projektimin, përshtatjen dhe standartizmin e rregulloreve të BE në fushën e transportit ajror, rregullore të listuara në draft aneksin e përditësuar të Marrëveshjes së ECAA, që dërgohet çdo vit nga Komisioni Europian në AAC së bashku me vlerësimet e vizitave vlerësuese të rradhës të kryera në vendin tonë.
- Projektimin, përshtatjen dhe standartizmin në funksion të implementimit të Anekseve përkatëse të ICAO-s në legjislacionin vendas, si një bazë e rëndësishme rregulluese për funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil si autoriteti garantues dhe mbikqyrës i standarteve të transportit ajror.

Referuar matricës së akteve së transpozuar në vijim të Marrëveshjes Shumëpalëshe, gjatë analizës së informacionit u evidentua se:

Numri total i rregulloreve për tu transpozuar është rreth 86.

Nga 85 rregullore statusi aktual paraqitet si më poshtë:

- Rregullore të cilat janë adaptuar deri më tani janë 36.
- Rregullore të cilat janë në fuqi por duhet të amendohen janë 12.
- Rregullore të cilat janë në proces transpozimi pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë janë 10.
- Rregullore të cilat nevojiten për t'u bërë, në proces draftimi pranë AAC-së janë 5.
- Rregullore të cilat nuk janë bërë deri më tani janë 18, nga të cilat 12 janë të fushës së Menaxhimit të Trafikut Ajror, 1 e Aksidenteve dhe Incidenteve, dhe 1 Neë Basic Regulation, 1 OPS/SAFETY, 1 nga mjedisi, 1 rregullore ekonomike dhe 1 për mrojtjen e konsumatorit.
- Rregullore të cilat janë të paaplikueshme de facto deri kur RSH të jete në EASA ose BE janë 8.

Është dërguar kërkesë për informacion institucioneve të tjera (AK,MT,AMK,MP) në lidhje me statusin e rregulloreve të Aneksit I përkatësisht sipas fushës së zbatimit.

### 5.3 Kontrolli, Ruajtja e Cilësisë dhe përfaqësimi në marrdhëniet me jashtë

Funksioni i kontrollit dhe ruajtjes së cilësisë ka konsistuar në ushtrimin e kontroleve të brëndshme të cilësisë, me qëllim identifikimin e nevojave për përmirsim në AAC, raportimin e mospërputhshmerive, menaxhimin e masave korigjuese, zbatimi i Manualit të Cilësisë në përputhje me standartin ISO i cili është dokumenti bazë për ngritjen e sistemit të menaxhimit të cilësisë në autoritet, duke unifikuar të gjitha hapat që do të ndiqen nga drejtoritë përkatëse në hartimin e rregulloreve, manualeve, proceseve, procedurave. Nëpërmjet këtij Manuali bëhet i mundur vendosja e parimeve kryesore të punës, rritja e cilësisë së punës si në planifikim ashtu dhe në raportim, identifikimi i dokumentave dhe qenia gjithmonë koherent me legjislacionin në fuqi dhe me versionin final, standartizimi i dokumentave nëpërmjet procedurës për menaxhimin e dokumentave, duke përfshirë në të të gjitha tiparet e detyrueshme që duhet të ketë një dokument qoftë ai i brëndshëm apo i jashtëm. Gjatë vitit 2018 AAC ka kontraktuar konsulencën teknike për ISO 9001:2015 me qëllim, hartimin e te gjithë dokumentacionit te nevojshëm për të certifikuar Autoritetin me ISO 9001:2015.

Kryesisht për vitin 2018 aktiviteti i SKRC ka konsistuar në:

- Regjistrimi i ngjarjeve në programin ECCAIRS;
- Realizimi i planit të auditimit sipas programit;
- menaxhimin e dokumentave dhe planifikimin e punës në AAC”

#### 5.3.1 Statistikat në lidhje me ngjarjet e raportuara për vitin 2018


Monitorimi i sigurisë së aviacionit është pjesë integrale e funksioneve të ushtruara nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Shqipërisë. Duke monitoruar nivelet e sigurisë në industrinë e aviacionit, AAC-ja mund të masë nëse rreziqet e sigurisë janë duke u vlerësuar në mënyrë të duhur dhe të identifikojë fushat në të cilat mund të përmirësohet siguria.

Raportimi i ngjarjeve kontribuon në masë të madhe në identifikimin reaktiv dhe proaktiv të rreziqeve të sigurisë dhe ndikon në përmirësimin e masave të sigurisë.

Qëllimi i raportimit të ngjarjeve është përmirësimi i sigurisë ajrore duke garantuar që të dhënat përkatëse mbi sigurinë të raportohen, mblidhen, ruhen, mbrohen dhe shpërndahen. Qëllimi i vetëm i raportimit të ngjarjeve është parandalimi i aksidenteve dhe incidenteve dhe jo përcaktimi i fajit apo i përgjegjësisë.

Në këtë aneks janë paraqitur statistikat për ngjarjet e ndodhura gjatë vitit 2018.

#### **Grafik.1** Numri i ngjarjeve të raportuara gjatë viteve 2014-2018




Grafiku 1 tregon numrin e ngjarjeve të raportuara në AAC me bazë vjetore (2014-2018). Gjatë viti 2018, siç tregohet në grafikun 1 janë raportuar gjithësej 371 ngjarje.

Ky numër paraqet një rritje të lehtë në krahasim me numrin e ngjarjeve të raportuara në 2017, 2016 dhe 2015, ku janë raportuar respektivisht 336, 305 dhe 246. Duke krahasuar numërin e ngjarjeve të raportuara gjatë këtyre pesë viteve, viti 2018 përfaqëson vitin e dytë me numërin më të lartë të ngjarjeve të raportuara gjatë katër viteve pas vitit 2014, kur janë raportuar 392 raste. Numri i ngjarjeve të raportuara në AAC, nga viti 2015 kur ECCAIRS<sup>1</sup> softëare është instaluar në AAC, deri në fund të vitit 2018, ka arritur një total prej 1650, ndërsa 232<sup>2</sup> janë probleme me linjat, të cilat nuk janë marrë në analizë në raportet vjetore sepse gjatë problemit është komunikuar nga teknika e vëndeve përkatëse se problemi është në pjesën e tyre.

Në total në programin ECCAIRS janë regjistruar 475 ngjarje për vitin 2018, prej të cilave 104 janë probleme me linjat e AFTN-së me Brindisit, Beogradin, Athinën, Romën, Maqedonin, Malin e Zi, Korfuzin. Ngjarje të cilat nuk janë marrë në analizë sepse gjatë problemit është komunikuar nga teknika e vëndeve përkatëse se problemi është në pjesën e tyre.

**Grafik.2:** Numri i ngjarjeve të raportuara në Vitin 2018.




<sup>1</sup> Në të cilin janë transferuar dhe ngjarjet e regjistruara në Excel file të vitit 2014.

<sup>2</sup> Numri total i ngjarjeve të regjistruara në sistemin ECCAIRS për vitin 2014-2018 janë 1889.

Grafiku 2, tregon numrin e ngjarjeve të raportuara në AAC gjatë vitit 2018. Në përputhje me trendin e ngjarjeve të raportuara në vitin e mëparshëm, vërehet një rritje e ngjarjeve të raportuara gjatë gjashtë mujorit të parë të 2018. Kjo rritje është në përputhje me trend rritjen e aktiviteteve të avionëve. Ndërsa në muajin Korrik 2018 vërehet një rritje e qëndrueshme dhe një numër uniform i raporteve. Ndërsa gjatë 6 mujorit të dytë vërehet një ulje e numrit të ngjarjeve të raportuara krahasuar me ngjarjet e raportuara në vitin e mëparshëm. Trendi ka arrit maksimumin e tij, gjatë periudhës Gusht. Kjo rritje është në përputhje me rritjen e aktiviteteve të avionëve gjatë muajve të verës dhe mund t'i atribuohet kryesisht rritjes së *Birdstrikes* dhe *Submit me Laser*. Gjatë kësaj periudhe AAC ka marr 7 raportime në lidhje me sulmin me laser dhe 10 raportime në lidhje me Birdstike.

**Grafik. 3:** Numri i ngjarjeve të raportuara në vitin 2018 sipas klasës së ngjarjeve



Duke vëzhguar trendin e ORs të marra në gjatë vitit 2018 në grafikun 3, vërehet se nga 475<sup>3</sup> ngjarje të raportuara, 27 janë klasifikuar si significant incident, 330 janë klasifikuar si not determined (keto ngjarje janë ngjarje ëithout safety affect, per te cilat regjistrimi I hedhjes ne sistem ndryshoi ne shtator 2018 pas vizites nga ekspertet e fushës së përdorimit të ECCAIRS), 62 si occurrence ëithout safety effect, 1 si major incident, 33 si Incident dhe 19 Observation. Numri i ngjarjeve të klasifikuara si significant incident është rreth 5.7 % e numrit të përgjithshëm, incident është rreth 6.9% e numrit të përgjithshëm, ndërsa si Observation rreth 4 % e numrit të përgjithshëm.

<sup>3</sup> Në total të regjistruara në ECCAIRS Softëare

**Tabela.1:** Ngjarjet e raportuara në vitin 2018 sipas kategorive dhe klasifikimit të risku

	Occurrence without safety effect	Not determined	Significant Incident	Major Incident	Incident	Observation	Total
ADRM	-	1	1	-	-	-	2
ATM/CNS:ATM	30	102	13	-	9	9	163
BIRD	1	20	-	-	3	-	24
FUEL	-	-	-	-	2	-	2
SCF-NP	11	11	-	-	5	1	28 <sup>4</sup>
SCF-PP	-	2	-	-	-	-	2
SEC	1	20	-	-	5	3	29
MAC	-	5	2	-	-	-	8 <sup>5</sup>
MED	-	2	-	-	-	-	2
TURB	-	-	-	-	1	-	1 <sup>6</sup>
ËSTRË	3	15	-	-	1	1	22 <sup>7</sup>
ËILD	-	-	-	1	-	-	1
Other	5	81	5	-	2	4	97+1 RAT
<b>Total</b>	<b>50</b>	<b>259</b>	<b>21</b>	<b>1</b>	<b>27</b>	<b>18</b>	<b>377</b>

Duke vëzhguar trendin e raporteve të marra në 2018 në tabelën 1, vlenë të theksohet se një pjesë e ngjarjeve të raportuara, rreth 43.2 % janë të lidhura me sistemin dhe procedurat e ATM-së, përfshirë edhe informacionin Aeronautik dhe shërbimet meteorologjike. Nga tabela 1 vërehet se rreth 62.5 % e ngjarjeve të ATM-së janë klasifikuar si not determined, 5.5 % si incident.

Ky trend thekson qëndrimin pozitiv dhe gadishmërinë e stafit operacional, veçanërisht të ANPS<sup>8</sup>, për të raportuar ngjarje të cilat nuk kanë efekt të dëmshëm në sigurinë e operacioneve, por të cilat ndihmojnë në vëzhgimin e trendit negative afatgjatë dhe në parandalimin e incidenteve serioze.

<sup>4</sup> Pesë ngjarje të klasifikuara si SCF-NP, Occurrence state: Italy, por janë marrë në analizë sepse janë ngjarje të raportuara nga Operatorit: Albawings. E klasifikuar edhe si ËSTRË për shkak të fluturimit në kohë të keqe.

<sup>5</sup> Një ngjarje e klasifikuar si MAC, Occurrence state: Italy, është marrë në analizë. Raportuar nga Operatori: Albawings.

<sup>6</sup> Raportuar nga Albawings, Occurrence state: Italy

<sup>7</sup> Occurrence state: Italy

<sup>8</sup> Air Navigation Services Provider

Nga tabela 1 vihet re se katogerit e tjera përveç ATM, të cilat kanë kontribuar në rritjen e numërit të ngjarjeve për vitin 2018 janë si më poshtë:

Bird (sulmi ga zogjtë), LA (Sulmi Laser) e klasifikuar si SEC (security), SCF-NP (Sistemi / Komponenti dështimi ose mosfunksionimi [jo-fuqi]), ËSTRË (Fluturimi në kohë të keqe, stuhi/erë) dhe OTHR (Tjetër).

### **5.3.2 Statistika në lidhje me raportimin në USOAP**

Programi USOAP është zhvilluar nga ICAO për të mundësuar raportimin e vazhdueshëm të shteteve në ICAO. Përmes programit/sistemit - shtetet raportojnë përmes NCMC-s.

Shteti ka për detyrim të plotësoj dhe të mbaj të përditësuar kategoritë: SAAQ, Vet-Vlerësimi, EFOD, CAP.


- Për kategoritë
- Legjislacioni
- Organizata
- Licensim Personeli
- Operimi Avioni
- Vlefshmëria Ajrore
- Investigim Aksident dhe Incident
- Shërbimet e Navigimit Ajror
- Aerodromet dhe Shërbimet në Tokë

Të gjitha kategoritë përfshijnë kategoritë e mëposhtme dhe kërkojnë informacion lidhur me të gjitha gjetjet dhe masat korrigjuese.

Nga Koordinatori Kombëtar për Monitorimin e Vazhdueshëm është mundësuar një panoramë e statusit të gjetjeve dhe progresit të bërë nga shqipëria nëpërmjet raportimit të vazhdueshëm në programin USOAP.

**Figura. 1:** Situata si paraqitet në sistem

Implementimi 55.09%



Veprimtaria:

Gjatë vitit 2018 u ngrit një grup pune i cili përmes Planit të Veprimit ka ndërmarrë iniciativën për të përditësuar të gjithë informacionin në sistem.

Vlen të themi që informacioni i Shqipërisë së fundmi është riparë:

CMA Audit (Full)	10.12.2009
ICAO Coordinated Validation Mission (LEG, ORG, ANS, AGA)	14.11.2012
Off-Site Validation Activity (PEL, OPS, AIR)	04.04.2014
Off-Site Validation (ORG, ANS)	28.03.2014

Pjesa me e madhe e Anekseve të ICAO-s është transpozuar, ndërkohë që janë plotësuar në sistemin USOAP, pranë kategorisë EFOD, tabelat e diferencave për anekset e transpozuar.

Përditësimet gjatë 2018 është punuar për Masat Korrigjuese:

Kategoria	Statusi
ANS	Përfunduar
LEG	Përfunduar
ORG	Përfunduar
PEL	Përfunduar
AGA	Në proces
AIR	Në proces
OPS	Në proces
AIG	Në proces

#### 5.4 Mbikqyrja e Shërbimit të Lundrimit Ajror

Misioni i Mbikqyrjes së Shërbimeve të Navigimit Ajror është rritja e standardeve në kryerjen e disa funksioneve kryesore për fushën operacionale siç janë:

1. Proçesi i Rregullbërjes në fushën e Shërbimeve të Navigimit Ajror
2. Proçesi i Çertifikimit dhe Mbikqyrjes së Ofruesve të Shërbimeve të Navigimit Ajror
3. Liçensimi i Personelit të Ofruesve të Shërbimeve të Navigimit Ajror

Nga auditet kryera në 2018, në fushat e ATS/AIS/CNS dhe TO situata është si më poshte:

Janar-Mars*	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mbikqyrja e Vazhdueshme e ANS/Komunikimet/Aprovimet etj</li> <li>2. Rritja e kapaciteteve dhe kualifikimeve brenda DHMSHLA (<i>disa trenerime në fushën e ATS dhe CNS</i>)</li> <li>3. Prodhimi i LSSP për 2017</li> <li>4. Përgatitja e Urdhërit të Përbashkët MIE dhe MM për Komitetin Kombëtar për menaxhimin e Hapësirës ajrore.</li> <li>5. Follow-up me EASA në mitigimin i gjetjeve (gjetjet janë on track dhe sipas grafikut të rënë dakord me EASA)</li> <li>6. Përgatitja e draftit të planit për E-TOD.</li> <li>7. Përgatitja e Draft-Planit Kombëtar të SAR me Ministrinë e Mbrojtjes.</li> </ol>
Prill-Qershor	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. U zhvilluar Audit ndjekës në ANSP për gjithë fushat e ATS, MET, AIS, CNS dhe TO</li> <li>2. U zhvillua mbledhja e Runëay Safety Team midis AAC, Albcontrol, TIA dhe MIL.</li> <li>3. U zhvillua takimi në Eurocontrol për Komisionin e përkohshëm</li> <li>4. U përditësuan të dhënat me EASA për gjetjet dhe UNC.</li> <li>5. U përmirësua manuali i mbikqyrjes për ANS</li> <li>6. U zhvillua takimi informues për regjistrimin e mjeteve ajrore parashyta dhe deltaplane si dhe për rregullat e ajrit me gjithë stakeholders të hapësirës (përdorues ajrore, Mil, Albcontrol dhe shoqatat aeronautike të regjistruara në shqipëri)</li> </ol>
Korrik-Shtator	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. LARA activity</li> <li>2. <i>Inspektimi për ATSEP (skema e kompetencës)</i></li> <li>3. <i>Inspektimi i AME</i></li> <li>4. Rregullorja e Deltaplaneve</li> <li>5. Zhvillimi i takimit për zonat e aktiviteteve me paraglajd dhe parashuta</li> <li>6. MOU për forcimin e rregullave të ajrit</li> <li>7. Draftimi i Reg 390 për skemën e performancës</li> <li>8. Zhvillimi i mbledhjes së RST</li> <li>9. Ndjekja e UNC-ve me ANSP</li> <li>10. Rritja e kapaciteteve dhe kualifikimeve brenda ANS (<i>trenerim në fushën e Safety dhe Human Factors nga EASA/JAR (4 personel)</i>)</li> </ol>

**AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL**

	11. Bashkëpunimi për Kodin ajror me Drejtoritë e tjera në AAC 12. Ndihmesa në draftimin e rregullores për dronet
Tetor -Dhjetor	1. Trejnimi me gjithë grupet e interesit për FUA dhe SERA me Eurocontrol 2. Konsultimi dhe dakordesimi i rregullores për FUA në të gjitha nivelet si dhe miratimi i tyre në MIE. 3. Takimi dhe indoktrinimi i gjithë grupeve të interesit për Loëer Airspace si dhe diskutimi mbi zonat për aktivitete sportive ajrore si dhe publikimi i tyre në AIP 4. Përgatitja dhe diskutimet mbi MOU për zbatueshmërinë e rregullave të ajrit. 5. Zhvillimi i Auditit vjetor për gjithë shërbimet navigacionale tek Albcontrol

ANSP aktualisht ka 83 Kontrollorë të Trafikut Ajror.(Sipas kategorive):

ADI/TËR	ACS/RAD	APS/RAD	OJTI	ASS
26	59	33	9	11

Për vitin 2018 janë validuar Licensa e mëposhtëme.


- 76 licensa për vlefshmërinë mjeksore
- 77 licensa për trajnimin rifreskues
- 11 licensa për aftësinë gjuhësore
- 55 licensa në kategorinë ACS
- 22 licensa në kategorinë TËR
- 30 licensa në kategorinë APS

Nga veprimtaria mbikqyrese e ANSP për 2018 kemi pasqyrën e mëposhtëme:

Gjetjet/Rekomandime Tek ANSP	Statusi	Kërkohet/Rekomandohet
3 rekomandime nga Auditimi i Follow up në Maj 2018	hapur	Kërkohet përmbushja e CAP
8 gjetje nga Auditimi i plotë në Dhjetor 2018	hapur	Kërkohet përmbushja e CAP


Gjatë periudhës të vitit 2018, fluksi i fluturimeve që ka përdorur hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë, i detajuar më poshtë ka patur një rritje në krahasim me një vit më parë. Kjo fale edhe struktura se re te hapësires ajrore, FRALB (Free Route Airspace) e cila kete sezon veror eshte aplikuar gjate gjithë dites.

Year	ATM
2009	161,402
2010	161,402
2011	197,265
2012	195,094
2013	200,578
2014	198,410
2015	201,990
2016	186,806
2017	193,872
2018	205,661



Lloji i ngjarjeve kryesore sipas kategorive tregohen me poshte:


Rreferuar ANSP, ne total gjate vitit 2018 ka patur 434 ngjarje te raportuara përfshire operacionale, teknike, ngjarje pjese e skemës se ngjarjeve te detyrueshme për tu përdorur por edhe jashtë kësaj skeme. Te gjitha këto ngjarje janë vlerësuar me RAT .



Ngjarjet Operacionale

Gjate vitit 2018 numri i ngjarjeve vetëm operacionale ka qene 122.

Te dhënat sipas Tokai vetëm për ngjarjet Operacionale te ndara sipas llojit.



## 5.5 Mbikëqyrja e Aeroporteve

Drejtoria e Mbikëqyrjes së Aeroporteve është përgjegjëse për kryerjen e çertifikimit, regjistrimit, monitorimit dhe mbikëqyrjen e aeroporteve në Republikën e Shqipërisë, si dhe rregullon dhe mbikëqyrë mjedisin fizik dhe teknik në afërsi të aeroporteve në përputhje me rregullat në fuqi.

Mbikëqyrja e aerodromit për operime të sigurta në kuptimin e gjerë nënkupton detyrat të cila janë kryer për zbatimin e programit të mbikëqyrjes në çdo kohë nga ana e AAC nëpërmjet DA për të verifikuar se kushtet sipas të cilave është dhënë një çertifikatë vazhdojnë të plotësohen gjatë periudhës të vlefshmërisë të saj.

Një nga bazat e menaxhimit efektiv të aerodromit është krijimi i një sistemi efikas mbikëqyrje.

Mbikëqyrja përfshin monitorimin e vazhdueshëm të gjithë aspekteve të operimit dhe menaxhimit të aerodromit si dhe të atyre që kryejnë shërbimet në tokë.

Monitorimi siguron një metodë tjetër proaktive për identifikimin e rreziqeve, vlerësimin e efektivitetit të veprimeve të sigurisë, si dhe vlerësimin e vazhdueshëm të performancës së sigurisë.

Në bazë të Kodit Ajror të RSH, në bazë të Urdhrit të Ministrisë të Transporteve Nr.130, datë 11/09/2012, për “Rregulloren për Çertifikimin, Regjistrimin e Aerodromeve dhe Detyrimet dhe Përgjegjësitë Operative që bien mbi Operatorët e Aerodromeve në fushën e Aviacionit Civil” si dhe Manualit Udhëzues i DA janë realizuar auditet dhe inspektimet si më poshtë:

Gjithashtu gjatë këtij viti është punuar për përmirsimin e procedurave të brendshme dhe të jashtme si dhe hartimin e manualeve udhëzuese për operatorin.

Gjatë tremujorit të parë është realizuar Mbikëqyrja dhe zbatimi i Studimit të fizibilitetit të një aeroporti në jug të vendit , ku Drejtori i DA ishte dhe Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të këtij studimi, ku objektivat specifike të këtij studimi përfshinin;

- Përshkrimin e survejimit të përgjithshëm për përcaktimin e vendeve të përshtatshme për aeroport në jug të vendit.
- Mbledhja dhe shqyrtimi i të dhënave të zonës së përdorur për parashikimin e trafikut dhe për përcaktimin e aspekteve teknike të zonave të përzgjedhura.
- Shqyrtimi aspekteve që ndikojnë në zonën e influencës të aeroportit të ri, siç është sistemi i transportit të Shqipërisë dhe situatat socio-ekonomike.
- Krahasimi i tre alternativave në mënyrë që të zgjidhet vendi më i përshtatshëm midis tyre. Analiza multikritere, kriteret e vlerësimit të cilat duhet të mbulonin të gjithë aspektet potenciale të implementimit të projektit dhe efektet e tij., vlerësimi nga pikëpamja social-mjedisore, gjeologjike, meteorologjike, hidrologjike, financiare, e trafikut, pengesave aeronautike, sistemit të infrastrukturës ekzistuese dhe teknike etj.
- Mbikëqyrja dhe sugjerime në lidhje me studimin e fizibilitetit të aeroportit të Kukësit.
- Hartimi i tabelave të përputhshmërisë për rregulloret 67/96 dhe 139/2014.

**AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL**

<b>Muaji</b>	<b>Lloji i aktivitetit Auditim/ Inspektim/ Teste/Studim</b>	<b>Përshkrimi i aktivitetit (fusha që do mbulohet)</b>	<b>Subjekti/ Operatori, i Audituar/ Inspektuar</b>
<b>Janar</b>	Kontroll në zyrë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Miratimi AOM</li> </ul>	TIA
<b>Shkurt</b>	Inspektim	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shërbimet De-Icing Anti-Icing</li> </ul>	TIA
<b>Mars</b>	Inspektim	<ul style="list-style-type: none"> <li>AEP</li> </ul>	TIA
<b>Prill</b>	Inspektim	<ul style="list-style-type: none"> <li>sistemin e menaxhimit të operatorit, duke përfshirë sistemin e tij të menaxhimit të sigurisë teknike dhe të cilësisë, si dhe sistemin e sigurisë të dhënave aeronautike; dhe</li> <li>ndihmesat vizuale dhe sistemet elektrike të aerodromit; dhe</li> </ul>	TIA
<b>Maj</b>	inspektim	<ul style="list-style-type: none"> <li>shërbimin e shpëtimit dhe fikjes së zjarrit;</li> <li>Kriteret e përbushjes së performancës</li> </ul>	TIA
<b>Qershor</b>	inspektim	<ul style="list-style-type: none"> <li>mbrojtja e radareve, ndihmesave navigacionale dhe pajisjeve të tjera të aerodromit;</li> <li>kriteret e përbushjes së performancës</li> <li>RTFS</li> </ul>	TIA
<b>Korrik</b>	auditim	<ul style="list-style-type: none"> <li>menaxhimin e platformës; dhe</li> <li>menaxhimi i sigurisë teknike të platformës;</li> <li>auditim i njoftuar për pika të ndryshme të operimit ( dhe Follow up i tij)</li> </ul>	TIA
<b>Gusht</b>	inspektim	<ul style="list-style-type: none"> <li>programi i operatorit të aerodromit për parandalimin e daljeve të avionëve nga pista dhe uljes të patregullt të avionëve në piste, si pjesë e programit të sigurisë teknike të pistës;</li> </ul>	TIA
<b>Shtator</b>	inspektim	<ul style="list-style-type: none"> <li>punimet në aerodrom; dhe</li> <li>trajnimi i personelit dhe regjistrimet e tyre, duke përfshirë rishikimin e programit të trajnimeve</li> </ul>	TIA
<b>Tetor</b>	inspektim	<ul style="list-style-type: none"> <li>kufizimi dhe kontrolli i pengesave;</li> <li>AEP</li> <li>shërbimet në tokë ( groundhandling)</li> </ul>	TIA
<b>Nëntor</b>	inspektim	<ul style="list-style-type: none"> <li>mbikeqyrjen e operatorit për pajtueshmërinë e organizatave që operojnë ose kryejnë shërbime në aerodrom (palët e treta).</li> </ul>	TIA
<b>Dhjetor</b>	inspektim	<ul style="list-style-type: none"> <li>koordinimit ndërmjet operatorit të aerodromit dhe furnizuesit e shërbimeve të tjera; dhe</li> </ul>	TIA

*Gjatë vitit janë kryer 11 inspektime pranë operatorit TIA-s.*

*Gjetje të rezultuara gjatë vitit 2018 pranë operatorit TIA janë 19, nga të cilat 17 janë të nivelit 2 dhe dhe observacione janë 2.*

## 5.6 Mbikqytja e Sigurisë në Aviacion

Objektivi parësor i DMSA është mbikqytja për zbatimin me efektivitet të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të pranuar, në fushën e sigurisë së aviacionit civil në Republikën e Shqipërisë, me qëllim mbrojtjen e aviacionit civil nga aktet e ndërhyrjes së paligjshme që rrezikojnë sigurinë e aviacionit civil.

DMSA nuk është e përfshirë drejtëpërdrejtë në zbatimin e masave të sigurisë, por ushtron përgjegjësitë ligjore në mirëmbajtjen dhe zhvillimin e kërkesave rregullatore dhe në monitorimet për verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat kombëtare dhe detyrimet ndërkombëtare. Në misionin për garantimin e sigurisë së aviacionit civil ne nuk jemi vetëm.

Në funksion të detyrave të DMSA janë realizuar detyrat e mëposhtme:

- Është kryer një vizitë vlerësuese në lidhje me verifikimin në vend të informacionit për pajisjet e sigurisë dërguar nga TIA datë 17.01.2018 dhe zbatimin e masave shtesë në lidhje me Incidentin e thyerjes së perimetrit në pjesën Forcave Ushtarake, dhe është hartuar Memo informuese për Drejtorin Ekzekutiv;
- Ka nisur procesi mbi projekt Memorandumin e Mirëkuptimit trepalësh të bashkëpunimit në fushën e sigurisë së aviacionit civil ndërmjet AAC, SHISH dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
- Është përcjellë te TIA informacioni mbi Pajisjet e Sigurisë (raportet e testeve për pajisjet e zbulimit të eksplozivëve në lëngjet –LEDS, Niveli 1 dhe Niveli 2) dërguar nga Konferenca Evropiane e Aviacionit Civil, ECAC;
- Është zhvilluar gjatë datave 16-19 Prill vizita vlerësuese për Dobësitë e zonës tokësore të Aeroportit “Nënë Tereza” nga ECAC.
- Është bërë një vizitë vlerësuese në Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza” mbi ndryshimin e gjurmës së perimetrit të aeroportit. (zonës së kufizuar të sigurisë)
- Ka përfunduar hetimi i sigurisë i kryer pranë Aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza” mbi incidentin e datës 16.05.2018.
- Janë mbyllur dy mbledhje të Komitetit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil .
- Është miratuar kërkesa mbi fillimin e punimeve në ndryshimin e kufirit të zonës së kufizuar të sigurisë pranë Portës A sipas projektit të paraqitur.
- Janë analizuar dhe në vijim miratuar ndryshimet në programet e sigurisë së “Albcontrol” sipas kërkesës së paraqitur.
- Pjesëmarrje në seminarin AVSEC Seminar (Global Aviation Security Plan) që u zhvillua në Shkup, në datat 12-14 Shtator 2018.

## AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

---

- Është kryer një Hetim i Sigurisë në lidhje me ngjarjen e raportuar nga TIA për shkeljen e masave të sigurisë në pjesën e HBS, pas kalimit të një femijë nëpër zinxhirin e bagazheve.
- Po rishikohet i gjithë kuadri rregullator ekzistues për sigurinë , pasi duhen updatuar me ndryshimet më të fundit të legjislacionit evropian.
- Çertifikimi & Riçertifikimi i kërkesave të paraqitura për punonjësit e ICTS, TIA, Albcontrol & Albawings ku janë shqyrtuar kriteret e rekrutimit, përzgjedhjes, pastërtia e figurës, kualifikimet e personelit, verifikimi i përputhshmërisë me kërkesat kombëtare para dhënies së çertifikimit dhe riçertifikimit.
- Çertifikimi i personelit të ICTS, në Total 48 punonjës, ku 15 Guarding & Patroll – agent, 21 Operator Skaneri- agent, 9 Supervizorë Operator Skaneri dhe G & P, 2 Duty Manager - Shef Turni dhe 1 Drejtues Sigurie- Menaxher Stacioni.
- Çertifikimi i Drejtuesit të Sigurisë – Menaxher Stacioni- Çertifikim i Drejtuesit të Sigurisë të Albawings- Çertifikim i Drejtuesit të Sigurisë të Albcontrol- Çertifikimi i Drejtuesit të Sigurisë të TIA-s.
- Riçertifikimi i punonjësve të ICTS, në Total 142 punonjës, nga të cilët 43 agent Guarding & Patroll, 80 agent – Operator Skaneri, 3 supervizor Guarding & Patroll, 8 Supervizor Operator Skaneri, 6 shefa turni, 2 Drejtues stacioni.
- Kontrolli i pastërtisë së figurës për personelin e ICTS, Albawings, Albcontrol, TIA. Në total u kërkuar kontrolli i pastërtisë për 437 punonjës, nga të cilët 171 punonjës të TIA-s, 198 punonjës të Albcontrol dhe 22 punonjës të Albawings dhe 26 ICTS.
- Ndjekja e trajnimeve të njoftuara nga Inspektorët e Sektorit të Çertifikimit dhe Mbikqyrjes së Personelit të Sigurisë për ICTS, Albcontrol dhe Albawings.

*Gjatë viti 2018 nga inspektimet e rezultuara pranë operatorëve, në vijim të përmbushjes së planit vjetor kanë rezultuar 31 Gjetje, nga këto 24 serioze, 5 të vogla dhe dy kërkojnë përmirsim.*

## AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

Për vitin 2018 aktiviteti i drejtorisë ka konsistuar në realizimin e plotë të planit të mbikqyrjes.

Data	Lloji i aktivitetit Auditim/Inspektim /Teste/Studim	Përshkrimi i aktivitetit (fusha e mbuluar)	Subjekti/ Operatori, i Audituar/ Inspektuar
21 Mars	Inspektim	Pajisjet e Sigurisë	TIA
25 Prill	Inspektim	Zbatimi masave sig HBS	TIA
26 Prill	Inspektim	Agjenti i Rregullt per Kargon -RA	RA
7 Maj	Testim i fshehtë	Pika e kontrollit të pasagjërve - PAX	TIA
22 Maj	Inspektim	Akses kontroll – Follow Up	TIA
16 Maj	Inspektim	Zbatimi i Masave të sigurisë për ATM	Albcontrol
21 Maj	Inspektim	Zbatimi i Masave të sigurisë për operatorin ajror	Albawings
12-13 Qershor	Inspektim	Aircraft search	Operatorët e Huaj
26 Qershor	Hetim	Incident I HBS	TIA
19 Korrik	Inspektim	Furnizimet e Aeroportit dhe Furnizimet në fluturim	TIA
22-24 Gusht	Inspektim	Aircraft search/ check	Operatorët e Huaj
31 Gusht	Testim i fshehtë	Porta A; check in	TIA
26 Shtator	Inspektim	Zbatimi masave sig, për furnizimet në fluturim	ICSI
03 Tetor	Testim i Fshehtë	HBS	TIA
09 Tetor	Inspektim	Agjenti i Rregullt -Kargo & Mail – Follow up	RA
16 Tetor	Albcontrol	Zbatimi masave sig ATM	Albcontrol
20 21 Nëntor	Inspektim	CCTV, Patrullim, perimetër, kontrolle fizike	TIA
19 Nentor	Inspektim	Zbatimi masave të sig.TA	Albawings
23 Nëntor	Inspektim	Akses kontroll- ID office	TIA
17-20 Dhjetor	Audit	I Përgjithshem	TIA

- 5.7 Mbrojtja e të drejtave të pasagjerëve

Gjatë vitit 2018 AAC dhe sektori i të drejtave të pasagjerëve në vecanti kanë luajtur një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të pasagjerëve. AAC ka luajtur rolin e një avokati ndihmës për çdo qytetar, me qëllim mbrojtjen dhe respektimin parimeve bazë të vendosura në rregulloren Europiane EC 261/2004 ,ose UM nr.1 datë 26.02.2013 “Për kompensimin dhe asistencën e pasagjerëve në rastin e mospranimit në bord të avionit dhe anulimit ose vonesës së gjatë të fluturimeve”.

Zyra e stafit të të drejtave të pasagjerëve në AAC, është alokuar pranë Tirana International Airport, Kati II, të cilët janë informuar çdo ditë mbi rastet e vonesave apo anulimeve të fluturimeve si dhe kanë asistuar në kohë pasagjerët.

Janë vendosur në aeroport fletëpalosjet me informacion për të drejtat e pasagjerëve:

- (1) udhëzues mbi të drejtat e pasagjerëve kur fluturojnë nëpërmjet ajrit;
- (2) udhëzues mbi të drejtat e pasagjerëve me aftësi të kufizuar lëvizëse;
- (3) udhëzues mbi të drejtat e pasagjerëve për humbjen e bagazheve ;

- SDP ka bërë të mundur mbajtjen nën kontroll dhe monitorimin me presencë nga afër për rastet e vonesave apo anulimeve të fluturimeve, duke kontrolluar apo mbajtur nën vëzhgim shpërndarjen e informacionit nga shoqëria ajrore respektive të info-s mbi të drejtat e pax si dhe në se ka dhënë asistencën e specifikuar të nevojshme sipas rastit.,sipas EC 261/2004 ,ose UM nr.1 datë 26.02.2013.

- Në rastet e përsëritura të vonesave apo anulimeve, SDP ka orientuar pasagjerët drejt vendndodhjeve të formularëve si në ambientet e check-in ashtu dhe në sallën transit, duke asistuar pasagjerët në mbushjen e formularëve të ankimimit.

- Në rastet kur formularët e mbushur të ankimimit janë dorëzuar pranë zyrës së SDP në aeroport apo nëpërmjet rrugës elektronike, është dhënë në vijim asistencë për çdo rast duke vijuar me ndërmjetësim/komunikim pranë shoqërisë ajrore, nëpërmjet komunikimit elektronik nga adresa e [pax@acaa.gov.al](mailto:pax@acaa.gov.al).

- SDP ka monitoruar procesin drejt dëmshpërblimit sipas përcaktimit kohor për t'u respektuar si dhe ka ushtruar influencën e vet në mënyrë që asnjë rast ankimimi i paraqitur të mos lihet mbas dore apo pa u trajtuar nga shoqëritë.

- Për çdo rast të paraqitjes së ankimimeve për dëmshpërblim, është hapur një dosje e vëçantë në emër të pasagjerit ankimues duke përditësuar ecurinë e rastit dhe duke informuar të interesuarin (pasagjerin).

- Komunikim dhe konsulencë në vazhdimësi me pasagjerët, nëpërmjet adresës [pax@acaa.gov.al](mailto:pax@acaa.gov.al) në ndjekje të procedurave të ankimimit. Ndjekje e rasteve deri në mbyllje të plotë të procedurës në komunikim shkresor dhe elektronik me kompanitë ajrore;

- Ndjekje e vazhdueshme e performancës së operatorëve ajrorë në tregun shqiptar;

- Njoftime dhe raportime periodike të DE në lidhje me problematikën e konstatuar në performancën e operatorëve ajrorë në treg;

- Gjate 3 mujorit të dytë të vitit 2018 ,

1. Kompania AUSTRIAN AIRLINES OS 843/ 03.05.2018 ka anuluar fluturimin nga TIA-VIE ku u plotësuan formularë ankimi për pasagjerët e këtij fluturimi Ndërkohe i kemi dërguar zyrës së kujdesit të pasagjerit të kompanisë AUSTRIAN AIRLINES emailin me formularët e ankimit dhe stafi I SDP ka njoftuar çdo pasagjer mbi procesin e ankimit ndaj Kompanisë deri në përfitim të kompensimit .Kompania Austrian Airlines krijoi CASE no . 1805-OS-04275 dhe një për secilin pasagjer detyrimin për kompensim .

2-Kompania ADRIA AIRWAYS JP 794 / 29Prill 2018 anuloi fluturimin nga TIA-FRA, u plotësuan formularë për 32 pasagjere dhe pas kontaktit me zyrën e kujdesit të pasagjerit të kompanisë ADRIA AIRWAYS mund të shprehemi se Kompania ka njohur të drejtën e kompensimit për pasagjerët e ankimuar , rreth 32 pasagjerë të ankimuar .

Problemet teknike të avionit dhe koha e keqe në Frankfurt kanë qenë arsytet për vonesat dhe anulime, ku përfaqësues të kompanisë dhe të aeroportit të TIA kanë menaxhuar asistencën tek pasagjerët, bazuar në rregulloren Europiane 261/2004.

-Trajtimi i ankesave në gjatë muajve **maj-qershor 2018** për kompanitë ajrore, Austrian Airlines - Adria AIRWAYS- Fly Ernest

- Komunikimi i vazhdueshëm dhe takim me përfaqësues të kompanisë ajrore Ernest mbi masat e marra për një operim në mënyrë korrekte sipas programit të miratuar, vendosja në plan të një marrëveshjeje të gjatë qiraje për të realizuar fluturimet e kërkuara, në mënyrë që pakësohet rastet e vonesave ose anulime për shkak të një flote jo të mjaftueshme;

- Nëpërmjet adresës së e-mailit të dedikuar vetëm për trajtimin e ankesave të pasagjerëve mbi të drejtat e tyre [pax@acaa.gov.al](mailto:pax@acaa.gov.al), ka arritur menaxhimi i rasteve në mënyrë korrekte dhe të duhur nëpërmjet komunikimit me kompanitë ajrore dhe me departamentin operacional të Aeroportit ;

- Kompania Ajrore Italiane Ernest nga 84 raste ankimi që ka patur gjatë dimrit 2017 ka mbyllur çështjen e 46 ankesave nëpërmjet kompensimit;

- Kompania Ajrore Italiane Blue Panorama njofton herë pas here mbi mënyrat e kompensimit të pasagjerëve sipas rastit ;

-Për ngjarjet e ndodhura gjatë muajit Korrik , kemi informacione të herëpashershme të përdituara nga Shoqëria Blue Panorama e cila ka krijuar një tabelë ekseli me numër dokumenti ( file number) mbi trajtimin e ankesave të ardhura nga pasagjerët direkt me status çështje të hapura ( open case) dmth që janë duke u shqyrtuar deri në reagimin e pasagjerit , dhe disa prej tyre kanë çështje të mbyllura( close file) , kur pasagjeri aprovon formën e kompensimit nga Kompania që mund të jetë në trajtë voucheri , kthim bilete ose në formë cash .

-Mbi çështjen e kompensimeve , për ngjarjet e ndodhura gjatë muajit Tetor , Nëntor , Dhjetor , kemi informacione të herëpashershme të përdituara nga Shoqëria Blue Panorama e cila ka krijuar një tabelë ekseli me numër dokumenti ( file number) mbi trajtimin e ankesave të ardhura nga pasagjerët direkt me status çështje të hapura ( open case) dmth që janë duke u shqyrtuar deri në reagimin e pasagjerit , dhe disa prej tyre kanë çështje të mbyllura( close file) , kur pasagjeri aprovon formën e kompensimit nga Kompania që mund të jetë në trajtë voucheri , kthim bilete ose në formë cash .

- Në total kemi nga kjo kompani 332 kompensime ( janar 2018-Dhjetor 2018) dhe rreth 670 raste të hapura (Open Case )

- Gjithashtu kemi një informacion të dërguar nga Kompania Ernest Spa e cila jep një numër të përgjithshëm të pasagjerëve që kanë kontaktuar direkt me kompaninë ( për ngjarje të datave të periudhës Gusht-Tetor 2018). Rezulton numri 381 i OPEN CASE / ERNEST S.p.A dhe 352 pasagjerë që do kontaktohen . 96 kompensime per ngjarjet e muajit janar dhe prill te 2018
- Informacion nga ALBAWINGS per kompensimet te disa pasagjarëve dhe disa cështje të hapura ku rezulton në total 25 pasagjerë të kompensuar dhe 20 raste të hapura .
- AUSTRIAN AIRLINES 12 pasagjerë te kompensuar
- ADRIA 28 pasagjerë te kompensuar dhe 5 raste të hapura ( Open case)
- AIR SERBIA 2 pasagjerë të kompensuar dhe 20 raste të hapura (Open Case)
- TOTAL 1136 OPEN CASE / 500 CLOSED CASE ( pasagjere te kompensuar )**

**Periudha JANAR –DHJETOR 2018**

<b>1.ALBAWINGS</b>	223 Formularë / 391 Pasagjerë
<b>2.BLUE PANORAMA</b>	763 Formularë/1176 Pasagjerë
<b>3.FLY ERNEST</b>	728 Formularë/1236 Pasagjerë
<b>4.ADRIA AIRWAYS</b>	44 Formularë/68 Pasagjerë
<b>5.AIR SERBIA</b>	17 Formularë/20 Pasagjerë
<b>6.AUSTRIAN AIRLINES</b>	11 Formulare/12 Pasagjere
<b>7 WIZZ AIR</b>	58 Formularë /85 Pasagjerë

**AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL**

Tabela e mëposhtme paraqet vonesat mbi 2 orë dhe anulimet e fluturimeve me nisje nga TIA , për të gjithë kompanitë ajrore të programuara që operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza”.

KOMPANIA		JAN	FEB	MAR	APR	MAJ	JUN	JULY	AUG	SEP	OCT	NOV	DEC
ALBAWINGS	Vonesa mbi 2 orë						1	5	7	10	7	2	10
	Anullime							1			2		
	orë	1	1	4		3	3	26	3	19	3		8
	Anullime							6					
ERNEST	Vonesa mbi 2 ore	5		1	9	5	1	1	19	5	6	1	19
	Anullime				3	1		2	6	1			1
ALITALIA	Vonesa mbi 2 ore							2				1	
	Anullime		1						1				
ADRIA	Vonesa mbi 2 ore	1	1	2	1						1	1	
	Anullime	1	1	2	2								1
AIR SERBIA	Vonesa mbi 2 ore								1			1	
	Anullime												
AUSTRIAN	Vonesa mbi 2 ore						1	1					1
	Anullime				1	1							
LUFTHANSA	Vonesa mbi 2 ore		1				1	1	2		1	1	
	Anullime				1			2					
TURKISH	Vonesa mbi 2 ore	1		2	1							1	
	Anullime												1
ËJZZ AIR	Vonesa mbi 2 ore	1						2	1			1	1
	Anullime												
JETAIRFLY	Vonesa mbi 2 ore										2		
	Anullime												
PEGASUS	Vonesa mbi 2 ore							1		1			
	Anullime												
BRITISH AIRWAYS	Vonesa mbi 2 ore		1	1	1			1			1		
	Anullime												1

### 5.8. Çështje të Administratës dhe Përfaqësimit Ligjore

#### Sektori i Prokurimeve

Gjatë vitit 2018 është realizuar rreth 60% e planit vjetor të prokurimit. Arsyet e mosrealizimit konsistojnë në:

- Rishikimin e Programit Ekonomik të vitit 2018 gjatë muajit Qershor, në të cilin u përfshin investime të reja;
- Lidhja e kontratës së qerasë ndërmjet AAC-së dhe Tërana Business Park, pas të cilës një pjesë e investimeve kryesisht të lidhura me godinën u bënë të panevojshme.

Gjatë vitit 2018 janë zhvilluar 44 procedura nëpërmjet sistemit dinamik të blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar, 20 procedura prokurimi me vlerë të vogël dhe 6 procedura me vlerë mbi 800.000 lekë, ndër të cilat janë:

Nr.	Objekti i prokurimit	Lloji i procedures	Fondi limit (pa tvsh)	Vlera e Kontratës (me tvsh)	Kontraktori
1	Rishikimi i Pavarur Ekonomik i Kontratës Konçesionare të TIA	Negocium pa shpallje	31.666.667	32.905.656	BDO Albania Shp.k
2	Asistencë teknike për hartimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001 : 2015	Shërbim Konsulence	7.083.333	7.774.200	TBI Consulting Sh.p.k
3	Sigurimi shëndetësor i punonjësve të AAC-së	Kërkesë për propozim	2.400.000	2.380.000 (pa tvsh)	Sicred Sh.a
4	Blerje karburant për nevojat e AAC-së	Kërkesë për propozim	2.083.333	2.500.000	A&T dhe Olsi Sh.pk
5	Ruajtja dhe siguria e AAC-së	Kërkesë për propozim	2.202.339	2.603.028	Eurogjici-Security
6	Ruajtja dhe siguria e Aeroportit të Kukësit	Negocium pa shpallje	2.466.387	2.430.937	“Shtiqni” Shpk
7	Ruajtja dhe siguria e Aeroportit të Kukësit	Procedure e Hapur	13.768.360	14.579.578	“Shtiqni” Shpk

#### Përfaqësimi ligjor

Numri i punonjësve të larguar për vitin 2018 është 27, ku 2 janë punonjës që kanë dhënë dorheqjen, 2 punonjës të larguar për lirim mbushje e moshës për pension, 12 punonjës të larguar për ndërprerje e marrëdhënieve të punës pasi emërimi ishte bërë në kundërshtim me Ligjin 152/2013, 1 punonjës i larguar për shkak të ligjit (Vendim i formës së prerë e dënuar penalisht), 1 punonjës i larguar si arsye

**AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL**

e zgjidhjes se Kont. Punës si arsye e uljes së mjeteve të transportit, 2 punonjës të larguar, lirim per shkak të ligjit, neni 37, pika 2, e ligjit 152/2013 (zgjedhjet në Këshillin Kombëtar të PD).

Gjatë vitit 2018 janë ndjekur 21 çështje gjyqësore të lidhura me marrëdhëniet e punës. Është bërë përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm ligjor për përfaqësim, raportimi dhe informimi me shkrim për çdo çështje të përfaqësuar;

**5.9 Cështjet Ekonomike**

**Të Ardhurat**

Sipas neni 17 të Ligjit nr. 10233, datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ardhurat e Autoritetit realizohen nga tarifat e vendosura për veprimtaritë që kryen Autoriteti.

000/Lekë

Nr.	Emërtimi	Realizimi Vjetor 2017	Programi Vjetor 2018	Realizimi vitit 2018	Realizimi 2018/2017 (%)	Realizimi 2018/Plan 2018 (%)
	<b>TOTAL (I+II)</b>		481,157	382,834		
	<b><i>Të ardhurat nga burimet e veta</i></b>	<b><i>351,203</i></b>	<b><i>481,157</i></b>	<b><i>382,834</i></b>	<b><i>109</i></b>	<b><i>80</i></b>
1	Tarifa e sigurisë	178,405	172,000	188,876	106	110
2	Tarifa e kostos në rrugë(en-route)	162,000	167,000	167,000	103	100
3	Liçensa e Aeroportit	6,788	7,000	6,462	95	92
4	Të ardhura nga liçenca tjera	4,010	4,500	18,780	468	417
5	Fondi rezervë miratuar nga KD		130,657			
6	Të ardhura të tjera			1,716		

Duke ju referuar tabelës së mësipërme:

- **Tarifa e Sigurisë** - Të ardhurat nga ky aktivitet për vitin 2018 janë realizuar në masën 10% më shumë, krahasuar me parashikimin vjetor dhe 6% më shumë krahasuar me realizimin e kësaj të ardhure për vitin 2017. Ky tejkalim ka ardhur si ndikim i rritjes së numurit të pasagjerëve të trajtuar në Aeroportin “Nënë Tereza” dhe konkretisht një rritje prej 10% më shumë krahasuar me vitin 2017.
- **Tarifa e kostos en-route**, është bërë kalkulimi koston bazë (unit rate) për Shqipërinë sipas metodologjisë së Eurokontrollit. Kjo e ardhur merret nëpërmjet ofruesit të shërbimit të lundrimit ajror Albcontrol, duke qenë se tarifa en-route arkëtohet në total bashkë me koston e Albcontrol-it.  
Vlen të theksohet se kjo kosto është variable dhe reflekton vetëm shpenzimet që bën realisht institucioni për këtë aktivitet. Realizimi për këtë zë është i plotë në masën 100%. Tarifa e

## AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

rrugës përbën një nga treuesit kryesorë të të ardhurave të Autoritetit, duke përfaqësuar 50% të të ardhurave totale. E ardhura nga tarifat e rrugës, për vitin 2018, rezulton me një vlerë 167 milion lekë. Duke qenë se parashikimi i kostos bëhet për një periudhë pesë vjeçare më poshtë po japim koston bazë në vite me një parashikim deri në vitin 2022.

	milion lekë								
Vitet	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Kosto bazë	131	147	162	162	167	164	163	163	162

- **Liçensa e Aeroportit**, e cila është e përcaktuar në Ligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së konçensionit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë Konçensionare Tirana Airport Partners, shpk, për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e Aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza“ Tiranë“ dhe për dhënien e disa stimuljeve kësaj Shoqërie dhe është një shumë fikse prej 50,000 Euro. Kjo shumë paguhet në një pagesë të vetme nga Aeroporti. Diferenca me parashikimin reflekton kursin e këmbimit në monedhën Euro.
- **Të ardhura të tjera nga liçencat** përfshihen të ardhurat që në vjelim nga dhënia e liçensave në fushën e aviacionit civil, në bazë të Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministrit të Financave, Nr. 2225 datë 13.05.2013. Kjo e ardhur është realizuar në masën 417% krahasuar me parashikimin 2018, kurse krahasuar me realizimin për vitin 2017 rezulton në masën 468%. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i lëshimit të dy Çertifikatave të Vlefshmërisë Ajrore për kompaninë Albawings. E para dhënë në muajin Janar 2018 dhe e dyta në fund të vitit 2018.
- **Të ardhura të tjera** përfshihen përfitime nga këmbimet valutore, të ardhurat nga interesa dhe gjopa, si dhe e ardhura nga dhënia me qira e një ambjenti të AAC.

### B. Shpenzimet

Autoriteti i Aviacionit Civil, në bazë të pikës 4 të nenit 17 të Ligjit nr. 10233, datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, i përdor të ardhurat e saj me qëllim mbulimin e shpenzimeve operative dhe investimeve kapitale të nevojshme për funksionimin normal të saj, si dhe për pagesat e kontributeve, që rrjedhin nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në organizmat ndërkombëtare të aviacionit civil.

Totali i shpenzimeve deri në fund të vitit 2018 rezulton në shumën 261,082 mijë Lekë kundrejt 356,750 mijë Lekë të parashikuara në planin e miratuar të buxhetit.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet një krahasim i shpenzimeve të realizuara për vitin 2018 kundrejt programit të miratuar:

Nr	Emertimi	Programi vjetor 2018	Realizimi Vjetor 2018	Diferenca në vlerë absolute	000/lekë
					% Realizimit 2018/plan 2018

**AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL**

1	Mallra	10,860	9,032	1,828	83
2	Furnitura dhe shërbime	32,750	25,802	6,948	79
3	Shërbime gjithsej	28,758	21,015	7,743	73
4	Trajnim stafi dhe trajtim personeli	42,000	19,815	22,185	47
5	Tatim taksa të tjera	11,070	9,717	1,353	88
6	Shpenzime personeli	219,312	148,662	70,650	68
7	Shpenzime të tjera rrjedhëse	2,200	797	1,403	36
8	Shpenzime financiare	300	12,542	-12,242	4181
9	Provizione (vendime gjyqsore)	5000	0	5,000	0
10	Amortizimi aktiveve afat gjata	4,500	13,700	-9,200	304
	<b>Totali</b>	<b>356,750</b>	<b>261,082</b>	<b>95,668</b>	<b>73</b>

- Zëri **“Mallra”** është realizuar në masën 83% krahasuar me parashikimin. Me përjashtim të nënzërit *“materiale të tjera konsumi”*, i cili është realizuar mbi vlerën e parashikuar, nënzërat e tjerë janë mbyllur me vlerë më të vogël se parashikimi i tyre. Kjo do të kërkonte rialokim të fondeve duke shtuar/pakësuar nënzëra sipas prioriteteve dhe nevojave që ka institucioni për ta sjellë në parametrat e parashikuar
- Zëri **“Furnitura dhe shërbime”** është realizuar në masën 79% krahasuar me parashikimin. Në këtë zë janë përfshirë disa nënzëra për të cilët janë kryer shpenzime në vlera shumë të vogla ose nuk është kryer asnjë shpenzim, si mirëmbajtje riparim kondicioneri, mirëmbajtje objekte ndërtimore, mirëmbajtje pajisjeve elektronike, mirëmbajtje pajisje elektrike dhe hidraulike, kjo për shkak të specifikës së prokurimeve.
- Zëri **“Shërbime gjithsej”** është realizuar në masën 73% krahasuar me parashikimin. Pjesën kryesore të shpenzimeve e zënë shpenzimet për *“udbëtime dieta jashtë vendit”*, i cili rezulton me një realizim 83% të parashikimit. Nënzërat e tjerë janë realizuar brenda vlerave të parashikuara për vitin.
- Zëri **“Trajnim stafi dhe trajtim personeli”** i programuar në shumën 42,000 mijë lekë, është realizuar në vlerën 19,815 mijë lekë. Realizimi në % është 47, kjo për faktin që një pjesë e trajnimeve të miratuara nuk u realizuan brenda vitit 2018. Më poshtë paraqitet % e trajnimeve të realizuara për çdo drejtori kundrejt totalit:

<b>Fondi shpenzuar trajnim stafi</b>	<b>DREJTORITE</b>
--------------------------------------	-------------------

**AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL**

	<b>Drejtor Ekzekutive Dhe Vartesisit</b>	<b>DMSHLA</b>	<b>DMOA</b>	<b>DMA</b>	<b>DMSA</b>	<b>DSHP</b>
000/Lekë	%	%	%	%	%	%
19,815	29	12	45	3	6	4

- Zëri **“Tatim taksa të tjera”** është realizuar në masën 88% në krahasim me parashikimin. Peshën kryesore në këtë zë, rreth 98%, e zënë kuotizacionet ndërkombëtare dhe diferencën taksat vendore e ato të regjistrimit të automjeteve.
- Zëri **“Shpenzime Personeli”** është realizuar në masën 68% në krahasim me fondin e planifikuar. Realizimi i ulët i këtij zëri ka ardhur si rezultat i vendeve vakante dhe numrit të shpërblimeve të dhëna për punonjësit. Në këtë zë përfshihen edhe pagesat për kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar, si dhe fondi i skemës së pensionit privat suplementar referuar Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”. Ky zë rezulton me një kursim prej 15% kundrejt parashikimit.
- Zëri **“Shpenzime të tjera rrjedhëse”** është realizuar në masën 36% në krahasim me planin. Kjo si rezultat i një kursimi në nënzërin *“Shpenzime Pritje përcjellje”* dhe mosrealizimit të nënzërit *“shpenzime për vorkshop”*.
- Zëri **“Shpenzime financiare”** kemi një realizim në 12,542 mijë lekë nga 300 mijë të parashikuara. Kjo rritje nga parashikimi është si rezultat i vlerësimit të llogarive në monedhë të huaj, me kursin e fundit të vitit, datë 31.12.2018 marrë nga Banka e Shqipërisë.
- Zëri **“Provizione”**, për vitin 2018 është parashikuar një vlerë prej 5,000 mijë lekë e cila i referohet Akt-Padive të ngritura nga ish punonjësit e AAC-së të cilët janë larguar nga puna.
- Zëri **“Amortizimi”**, është një shpenzim, i cili përlllogaritet me mbylljen e vitit financiar dhe hartimin e pasqyrave financiare vjetore dhe sipas përlllogaritjeve është në shifrën 13,700 mijë Lekë, nga 4,500 mijë lekë të planifikuar. Normat vjetore të amortizimit të marra parasysh në këtë llogaritje janë bazuar në Udhëzimin Nr. 8 datë 09.03.2018 e Ministrisë së Financave.

### **C. Investimet**

Bazuar në programin e investimeve për vitin 2018, AAC planifikoi që të realizonte investime të financuara nga “burimet e veta”, me vlerë totale 105,000 mijë lekë të ndara këto sipas strukturës së mëposhtme. Realizimi i detajuar sipas zërave jepet në vlerë absolute dhe në përqindje kundrejt planit në tabelën e mëposhtme:

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Programi 2018</b>	<b>Realizimi 2018</b>	<b>% Realizimit 2018</b>
	<b>Totali i Investimeve</b>	<b>105,000</b>	<b>37,277</b>	<b>36</b>

000/lekë

**AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL**

	<b>(I+II+III)</b>			
<b>I</b>	Ndërtime e Montime	4320	288	7
<b>II</b>	Pajisje zyre, pajisje informatike & elektronike	17,100	173	1
<b>III</b>	Aktive të patrupëzuara	83,580	36,816	44

Investimet janë realizuar në shumën 37,277 mijë lekë, e cila përfaqëson 36% të vlerës së parashikimit.

- Zëri **“Ndërtime dhe montime”** është realizuar në masën 7% të parashikimit. Ky mosrealizim vjen si pasojë e vendimarrjes për pezullim të investimeve në zyrat ekzistuese për shkak të transferimit të zyrave në ambiente të reja me qira.
- Zëri **“Pajisje zyre, pajisje informatike & elektronike”**, ishte parashikuar në vlerën 17,100 mijë lekë. Ky zë nuk u arrit të realizohet brenda vitit 2018 dhe u planifikua për vitin 2019.
- Zëri **“Aktive të patrupëzuara”**, ishte parashikuar në vlerën 83,580 mijë lekë. Ky zë u realizua në masën 44%, për arsye se Nënzëri *“Vlerësim i pavarur ekonomik i kontratës konçensionare TLA”*, edhe pse kontrata u lidh në vitin 2018, përfundoi dhe u krye pagesa në fillim të vitit 2019

## 6. STATISTIKAT

### Zhvillimi i Transportit Ajror, dhënia e lejeve të fluturimit

Sipas të dhënave zyrtare që Sektori i Lejeve të Fluturimit disponon, në vitin 2018 u arrit një shifër rekord për sa i përket numrit të pasagjerëve që kanë udhëtuar nëpërmjet linjave ajrore për/nga vendi ynë. 2,947,172 ishte numri i pasagjerëve përgjatë këtij viti, numër ky 12% më i lartë se ai i një viti më parë. Janë shënuar në total 176,130 mbikalime dhe 25,510 ulje – ngritje nga Aeroporti Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, të ndara përkatësisht në:

- 22,042 linja të rregullta
- 3,326 charter
- 142 avionë ushtarak & të përjashtuar.

Numri i destinacioneve këtë vit ka qënë 51 dhe numri i kompanive të cilat kanë operuar fluturime të rregullta ka qënë 20.


Në Tabelen 1, pasqyrohet numri i pasagjerëve sipas kompanive për vitin 2018.

NR	Shoqëritë ajrore	PASAGJERË	
		Janar-Dhjetor 2018	Zotërimi i tregut në%
1	Swift Air	-	-
2	Adria AIRWAYS	116,447	4%
3	Alitalia	255,781	9%
4	Austrian Airlines	168,029	6%


**AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL**

5	British AIRWAYS	97,758	3%
6	Jetairfly	51,247	2%
7	Lufthansa	62,420	2%
8	Aegean Airlines	99,983	3%
9	Turkish Airlines	189,702	6%
10	Pegasus Airlines	99,588	3%
11	Blue Panorama	630,551	21%
12	Air Serbia	46,361	2%
13	Mistral Air	11,678	0%
14	Albawings	320,642	11%
15	Air Valle	0	0%
16	Volotea	14,516	0%
17	Ernest Airlines	363,969	12%
18	Transavia	46,404	2%
19	WIZZ Air	98,082	3%
20	Pegasus Airlines (ayt)	4,134	0%
21	Transavia (TO)	3205	0%
22	Charter	266,675	
	<b>TOTAL</b>	<b>2,947,172</b>	

Grafiku Nr. 1 pasqyron më qartë zotërimin në total të tregut sipas kompanive përgjatë vitit 2018.



Grafiku Nr. 2: Zotërimi i tregut nga ana kompanive, sipas përqindjes:




Fluksin më të madh të pasagjerëve përgjatë vitit 2018 duket se e mban kompania italiane “Blue Panorama” me 630,551 pasagjerë, 21 % ndaj totalit. Ndjekur nga Ernest S.p.A me 363,969 pasagjerë dhe 12 % ndaj totalit. Albawings gjithashtu ka një përqindje të lartë në zotërimin e tregut për vitin 2018 me një shifër totale prej 320,642 pasagjerë dhe 11%.

Sikurse është theksuar edhe më sipër Korriku dhe Gushti janë muajt të cilët pasqyrojnë kulmin e kurbës për sa i përket numrit total të pasagjerëve në vitin 2018, pasqyruar në grafikun numër tre. Ky faktor vjen si rrjedhojë e numrit të shtuar të kompanive charter të cilat operojnë në Shqipëri, këtë vit kanë qënë 14 të tilla, 4 nga të cilat operojnë për herë të parë në tregun tonë dhe 6 destinacione të reja.

Sipas shifrave në tabelën numër 2, ku pasqyrohet numri i pasagjerëve që kanë fluturuar me charter përgjatë tre viteve të fundit nga viti 2017 në vitin 2018 ka pasur një rritje prej 55% dhe zë 9% të tregut në total.

**Grafiku Nr. 3:** Numri i pasagjerëve përgjatë vitit 2018 sipas muajve



**Tabela Nr.2:** Numri i pasagjereve sipas kompanive përgjatë tre viteve të fundit.

PASAGJERË Janar - Dhjetor 2016-2017-2018						
	Shoqëritë Ajrore	2016	2017	2018	% e ndryshimit 2017-2016	% e Ndryshimit 2018-2017
1	Sëift Air	-	-	-		
2	Adria AIRWAYS	106,758	114,647	116,447	7.39%	1.57%
3	Alitalia	424,385	282,275	255,781	-33.49%	-9.39%
4	Austrian Airlines	159,109	174,363	168,029	9.59%	-3.63%
5	British AIRWAYS	73,260	84,650	97,758	15.55%	15.48%
6	Jetairfly	42,309	45,811	51,247	8.28%	11.87%
7	Lufthansa	60,278	61,236	62,420	1.59%	1.93%
8	Aegean Airlines	78,349	84,860	99,983	8.31%	17.82%
9	Turkish Airlines	153,369	172,719	189,702	12.62%	9.83%
10	Pegasus Airlines	65,234	89,265	99,588	36.84%	11.56%
11	Blue Panorama	685,054	737,168	630,551	7.61%	-14.46%
12	Air Serbia	41,107	47,126	46,361	14.64%	-1.62%
13	Mistral Air	76,581	80,195	11,678	4.72%	
14	Albawings	55,666	208,261	320,642	274.13%	53.96%
15	Air Valle	7,316	-	-		
16	Volotea	17,628	11,176	14,516	-36.60%	29.89%
17	Ernest Airlines		184,067	363,969		97.74%
18	Transavia		50,652	49,609		-2.06%
19	ËIZZ Air		30,321	98,082		223.48%
20	Pegasus Airlines (Antalya)		-	4,134		
	<b>Shuma</b>	<b>2,046,403</b>	<b>2,458,792</b>	<b>2,680,497</b>	<b>20.15%</b>	<b>9.02%</b>


**AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL**

20	CHARTER	148,697	171,546	266,675	15.37%	55.45%
	TOTAL	2,195,100	2,630,338	2,947,172	19.83%	12.05%
	% charterit ndaj totalit	7%	7%	9%		

Viti 2018 e ka çuar në 12% më të lartë se një vit më parë numrin e pasagjeve.

Analiza krahasuese mes tre viteve të fundit tregon se kompania “Blue Panorama” edhe pse përgjatë vitit 2018 rezulton kompania me shumë pasagjerë, ka humbur 15 % në treg nga viti 2017 ku numri i pasagjerëve ka qënë 737,168 kjo si pasojë se Italia zotëron më shumë se 50% të tregut tonë dhe numri i kompanive që operojnë në të është i lartë. Një nga këto kompani është edhe kompania shqipëtare Albawings e cila duket se e ka rritur ndjeshëm numrin e pasagjerëve nga viti 2017 në vitin 2018 me 54%. Kompania italiane Ernest S.p.a e cila gjithashtu operon fluturimet e saj drejt Italisë duket se ka një rritje të numrit të pasagjerëve me 98% krahasuar me 2017.

**Grafiku Nr. 4:** Numri i pasagjerëve për 2016, 2017, 2018 sipas operatorëve ajrorë.



Por kompania që ka rritjen më të lartë të fluksit të pasgjerëve nga vitin 2017 në vitin 2018 është kompania WIZZ Air, e cila që prej hyrjes në treg në fillim të vitit 2017 ka pasur shifra në rritje të vazhdueshme, kjo si pasojë e çmimeve Low Cost që ofron dhe shërbimit të mirë që kanë marrë pasagjerët. Tabela nr. 2, pasqyron rritjen e fluksit në vitin 2018 me 200% më të lartë se sa në vitin 2017.


**Tabela Nr.3:** Transporti Cargo sipas operatorëve ajrorë

	Viti 2017			Viti 2018		
	Mallra	Posta	Totali	Mallra	Post	Total
Janar	124,684	38,549	163,233	133,575	48,937	182,512
shkurt	126,122	41,031	167,153	128,233	39,894	168,127
Mars	153,362	38,494	191,856	136,539	38,033	174,572

**AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL**

Prill	139,315	34,576	173,891	154,585	36,689	191,274
Maj	182,328	36,093	218,421	145,805	36,999	182,804
Qershor	160,649	34,413	195,062	145,523	35,770	181,293
Korrik	155,521	32,244	187,765	147,966	32,721	180,687
Gusht	155,979	32,610	188,589	133,395	31,675	165,070
Shtator	148,273	35,358	183,631	147,996	31,675	179,671
Tetor	153,586	40,938	194,524	161,108	44,160	205,268
Nentor	147,300	42,898	190,198	164,325	44,178	208,503
Dhjetor	133,575	48,937	182,512	151,456	46,106	197,562
<b>Totali</b>	<b>1,780,694</b>	<b>456,141</b>	<b>2,236,835</b>	<b>1,750,506</b>	<b>466,837</b>	<b>2,217,343</b>

**Grafiku 5:** Transporti Cargo sipas operatorëve ajrorë



Statistikat si më lartë i raportohen çdo muaj Drejtorit Ekzekutiv si dhe Këshilltarit për media i cili më pas i bënë publike në buletin muajor të AAC.

Sektori i Lejeve të Fluturimit në vitin 2018 ka dhënë 1122 numra klerance për fluturimet jo të rregullta, ku përfshihen fluturimet charter seri, charter privat, fluturime diplomatike, arial ëork, cargo etj..


Për sa më sipër Specialistët e Lejeve të Fluturimit sigurohen që kërkesat e ardhura nga operatorët të marin përgjigje në kohë reale gjithashtu në mënyrë profesionale dhe shumë të shpejtë arrijnë të menaxhojnë fluksin e kërkesave dhe kryejnë detyrën e tyre përgjatë 24 orëve të ditës, ku nuk bëjnë përjashtim ditët e pushimit si dhe ato të festave.

Specialistët gjithashtu janë në komunikim të vazhdueshëm me Albcontrol për çdo problematikë, si me anë të postës elektronike ashtu dhe ndëpërmjet telefonit përgjatë 24 orëve të ditës. Ky sektor ka treguar vigjilencë në spikatjen e fluturimeve ferry dhe faturimin i shumave përkatëse për llogari të AAC. Përgjatë vitit 2018 ka akumuluar 3,325,000 ALL.

Sektori i Lejeve të Fluturimit ka hasur porblematika të shumta dhe ndryshme përgjatë vitit 2018. Problematika kryesore është menaxhimi i problemeve që kanë krijuar kompanitë italiane në treg, si

vonesat, ndryshimet e shpeshta të avionëve për të cilat gjithmon njoftohet sektori i lejeve të fluturimit. Mes kompanisë italiane Ernest dhe AAC janë shkëmbyer 31 letra zyrtare dhe me qindra emaile si dhe 21 letra me kompaninë Blue Panorama. Gjithashtu një nga problematikat e hasura gjatë 2018 mbetet mos zgjidhja e situatës me Federatën Aeraonautikës Shqiptare, për sa i përket hedhjeve me paragljajder nga ballkoni i Dajtit.

**Grafiku Nr. 4:** Numri i pasagjerëve për 2016, 2017, 2018 sipas operatorëve ajrorë.



Por kompania që ka rritjen më të lartë të fluksit të pasagjerëve nga vitin 2017 në vitin 2018 është kompania WIZZ Air, e cila që prej hyrjes në treg në fillim të vitit 2017 ka pasur shifra në rritje të vazhdueshme, kjo si pasojë e çmimeve Loë Cost që ofron dhe shërbimit të mirë që kanë marrë pasagjerët. Tabela nr. 2, pasqyron rritjen e fluksit në vitin 2018 me 200% më të lartë se sa në vitin 2017.

**Tabela Nr.3:** Transporti Cargo sipas operatorëve ajrorë

	Viti 2017			Viti 2018		
	Mallra	Posta	Totali	Mallra	Post	Total
Janar	124,684	38,549	163,233	133,575	48,937	182,512
shkurt	126,122	41,031	167,153	128,233	39,894	168,127
Mars	153,362	38,494	191,856	136,539	38,033	174,572
Prill	139,315	34,576	173,891	154,585	36,689	191,274
Maj	182,328	36,093	218,421	145,805	36,999	182,804
Qershor	160,649	34,413	195,062	145,523	35,770	181,293
Korrik	155,521	32,244	187,765	147,966	32,721	180,687
Gusht	155,979	32,610	188,589	133,395	31,675	165,070
Shtator	148,273	35,358	183,631	147,996	31,675	179,671
Tetor	153,586	40,938	194,524	161,108	44,160	205,268
Nentor	147,300	42,898	190,198	164,325	44,178	208,503

**AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL**

Dhjetor	133,575	48,937	182,512	151,456	46,106	197,562
<b>Totali</b>	<b>1,780,694</b>	<b>456,141</b>	<b>2,236,835</b>	<b>1,750,506</b>	<b>466,837</b>	<b>2,217,343</b>

## 2. Statistika lidhur me fluturimet

Ne vitin 2018 ne Shqiperi jane kryer 205.662 fluturime IFR ,me nje rritje prej 6.1% krahasuar me vitin 2017 (rritja perkatese per rrjetin ne pergjithesi ishte 3.8%).

Mesazhi kryesor i raportit te fundit Mjedisit te Aviacionit European 2019 ( i prodhuar nga EASA, Agjensia Europiane e Mjedisit dhe Eurocontrol) eshte se edhe pse efikasiteti mjedisor vazhdon te permiresohet,keshtu qe deri ne vitin 2040 mesatarja e djegjes se karburantit per pasagjer duhet te bjere me 12% dhe energjia e zhurmes per fluturim 24% ,emetimi i CO<sub>2</sub> dhe NO<sub>x</sub> ka gjasa te rriten perkatesisht se paku me 21% dhe 16%. Pavaresisht perpjekjeve me te mira te industrise se aviacionit per te zbutur ndikimet e saj globale dhe lokale ,rritja e vazhdueshme e trafikut ,deri me tani, e tejkalon aftesine e industrise per te zhvilluar teknologjine ,masat e bazuara ne treg dhe permiresimet operacionale e mbyllin hendekun.

Persa i perket emetimit te CO<sub>2</sub> ,ETS Support Facility i Eurocontrol prodhon disa te dhena te cilat mund te jene ne interesin tuaj. Ketu kemi ndjekur formatin e miratuar nga paneli nderqeveritar per ndryshimin e klimes,ne te cilin raportimi nga shtetet eshte ne baze te emetimit per te gjitha fluturimin i cili eshte nisur nga nje shtet i caktuar. Prandaj, kjo perfshin fluturime te brendshme, dhe nisje nderkombetare po

r perjashton mbifluturimet dhe mberritjet nderkombetare. Bazuar ne kete emetimi i CO<sub>2</sub> per Shqiperine ne vitin 2018 arriti ne 143.862 ton, 12% me shume se ne vitin 2017 (numri i fluturimeve pergjegjese per keto emisione u rrit me 3.8% ).

Gjate kesaj periudhe Albcontrol nuk ka gjeneruar vonesa (krahasuar me 186 minuta ne vitin 2017).

Ne rrjetin European si nje i tere ,vonesat ne menaxhimin e rrjedhes ne vitin 2018 arriten ne 25.6 milion minuta (61.3% me shume se ne vitin 2017).

Per fluturimet qe largohen nga Shqiperia, 10 destinacionet kryesore jane treguar me poshte,bashke me mesataren e vonesave te ATFM lidhur me te gjitha fluturimin.

Nisje nga Shqiperia 2018	Fluturime(mesatarja ditore)	% e vonesave te fluturimeve per shkak te ATFM	Vonesa mesatare ATFM per fluturim te vonuar (min)
Itali	17.7	2%	20.1
Turqi	3.4	23%	20.3
Gjermani	2.1	27%	25.2
Greqi	1.9	13%	16.6
Austri	1.9	10%	22.0
Mbreteria e Bashkuar	1.4	27%	20.0
Serbia dhe Mali i Zi	1.2	0%	0.0
Sllloveni	1.1	6%	14.1
Poloni	0.9	15%	19.2
Belgjiqe	0.6	32%	17.9

## AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

10 kompanite kryesore te renditura sipas numrit te mberritjeve ne aeroportin Shqiptar gjate vitit 2018 tregohen ne tabelen me poshte :

Mberritjet ne Shqiperi 2018	Fluturime (mesatarja ditore)
Blue Panorama	6.3
Ernest Airlines	4.3
Albawings	3.9
Alitalia	2.8
Turkish Airlines	2.1
Adria Airways	2.0
Austrian Airlines	1.8
Air Serbia	1.1
Aegean Airlines	1.0
Lufthansa	1.0

Per llogari te Shqiperise , Eurocontrol u ka faturuar kompanive ajrore 24.6M € tarife rruge per vitin 2018.

Kjo shume eshte 7.1% me e larte se ne vitin 2017 dhe perfaqeson 0.30% te te gjithe tarifave te rruges te faturuara nga Eurocontrol .

10 Kompanite më të mira ajrore (bazuar në sasinë e tarifave të korridorit ajror) faturuar në emër të Shqipërisë për 2018 mund të gjenden në tabelën e mëposhtëme:

	Tarifat e Rrugës në M€
Turkish Airlines	1.5
Aegean Airlines	1.5
TUI Group	1.4
easyJet	1.3
Thomas Cook Group	1.1
British Airways	1.1
Air France	0.9
Ryanair	0.9
EGYPTAIR	0.8
SWISS	0.8

## Performanca e Rrjetit European

Performanca e rrjetit në 2018 dominohej nga vonesa shumë të mëdha gjatë verës. Vonesat në total ATFM për vitin e plotë ishin 25.6 milion minuta, deri në 61% nga 2017; kjo për shkak të vonesave ATFM gjatë korridorit ajror më shumë se dyfishi, siç tregohet më poshtë.

2017		2018	% ndryshimit
Vonesat ATFM në Aeroport	6,575,093	6,574,745	0.0%
Vonesat ATFM gjatë korridorit ajror	9,314,510	19,052,478	104.5%
Vonesat ATFM në total	15,889,063	25,627,223	61.3%

E gjithë kjo vjen me një çmim. Kosto totale ekonomike e vonesave dhe konstelacionet për gjithë 'të gjithë shkaqet' në 2018 arrijnë sasinë e €17.9 bilion dhe përafërsisht 350 milion pasagjerë u ndikuan nga vonesat apo anulimet. Kostoja ishte mbi €3.9 bilion më e lartë se në 2017. Vonesat gjatë korridorit ajror, të cilat janë më shumë se dyfishi, luajnë një rol domethënës në këtë dëmtim në performance ekonomike.

EUROCONTROL si Menaxher Rrjeti ka punuar shumë me gjithë palët e interesuara për të reduktuar impaktin e mungesës së kapacitetit. Përveç iniciativës së NM/4ACC (e cila ruajti 5 milion minuta të vlerësuara të vonesave), veprime të tjera specifike NM rezultuan në vonesa rreth 3.5 milion minuta më të ulëta se sa duhej të ishin.

Shqetësimi kryesor e pasagjerëve është që fluturimi e tyre të jetë në kohë, pamvarësisht nëse vonesa është menaxhim i rrjedhës, e kompanisë ajrore apo kundërshtuese. Këtu, mbërritja në kohë përgjatë gjithë vitit u ul me 75.7% të fluturimeve që mbërrijnë Brenda 15 minutave apo më herët nga koha e skeduar, krahasuar me 79.6% në 2017. Mesatarisht, fluturimet të cilat nuk plotësojnë këtë masë përpikmërie prej 15 minutash janë vonuar 49 minuta në nisje dhe 50 minuta në mbërritje (gjithë-rastet).




Tabela tragon Fraksionin e fluturimeve në % për gjithë rastet në vitin 2017 dhe 2018

Duke pasur parasysh këtë, fokusi për 2019 duhet të jetë mbi adresimin e vonesave që kanë ndikimin më të madh në këtë performance. Kjo do të thotë jo vetëm të fokusohesh në zonat që gjenerojnë vonesat më të mëdha por gjithashtu të përqëndrohesh në fillimin e ditës. Një vonesë e menaxhimit rrjedhës domethënëse në mëngjes mund të rezultojë në vonesa kundërshtuese për avionin për pjesën tjetër të ditës.

Në zonat që gjenerohen vonesa, është e qartë që shumë shtete i gjenerojnë nga kapaciteti i ulët. Disa hasin probleme kapaciteti si rezultat i trafikut shtesë duke u munduar të shmangin edhe vonesat e larta në shtetet fqinje. Megjithatë, disa shtete nuk ishin as në gjendje të përmbushnin, vazhdimisht,

nivelet e kapacitetit për të cilat ishin angazhuar në Planin e Operimeve të Rrjetit ose nivelet e kapacitetit për të cilat ishin angazhuar nuk ishin të mjaftueshme.

***Kapaciteti në Shqipëri***

Edhe pse mungesa e kapacitetit vitin e kaluar ishte një shkak kryesor për vonesat e korridorit ajror për rrjetin në tërësi, ACC e Tiranës nuk ishte një kontribues i këtyre vonesave, në linjë me angazhimin e saj në Planin e Operimeve të Rrjetit.

Në ndjekje të rritjes së 2018 me 6.1% në Shqipëri, parashikimi i fundit për 2019 është 4.5% (e lartë 6.6%, e ulët 2.2%).